

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7666 E hënë 1 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**  
**Prangat në duart e Rexhep Rrajës** nuk janë as një rast për të bërë fitore, dhe aq më pak një çast gëzimi se drejtësia me sa duket po funksionin. Sepse ...  
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI  
**Prangat e padrejta në duart e Rexhepit**



**Opinion** *i* **Ditës**  
**Presidenti serb Aleksandër Vučić** tha se me prezencën e njëjësive speciale të policisë së Kosovës ROSU në veri të Kosovës, u kërcënua dhe u sulmua paqja ...  
Vijon në faqen 21

Nga BEKIM SHEHU  
**Vizita e Thaçit në Ujman** shqetësoi tej mase Beogradin



ISSH: Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët

## Si të rrisni masën e pensionit, procedura e rishqyrtimit dhe mënyra e aplikimit

Të përfitosh më shumë të ardhura. Sigurimi vullnetar, çfarë duhet të bëjnë pensionistët

VOLTIZA DURO

Jo pak të moshuar shfaqin pakënaqësi në lidhje me pagesën që iu takon, në momentin që merret vendimi lidhur me masën e pensionit të përgjithshëm. Por ka ende disa mënyra për të rritur masën e pensionit...

Në faqen 12

## AKUZOHEK SE PERENDOQI 25-VJEÇAREN XHISELA MALOKU, NGJARJA

# ARRESTOHET REXHEP RRAJA, DJALI I DEPUTETIT TE PS

PD: Prangosja, truk për të mbyllur skandalin. Kryeministri Rama: Prokuroria t'i shkojë në fund. Balla: Përpara ligjit jemi të barabartë



(Në foto) Xhisola Maloku. Rexhep Rraja

Në faqen 2-5


**EMRI I MAQEDONISE**  
Dështon referendumi, votuan vetëm 34.76%. Kreu i Kuvendit nuk ishte në listë  
Në faqen 8

**FESTIVALI I TEATROVE**  
Kritika krijon çarje dhe armiqësi, Këta: Shtfaqja e Shkodrës e politizuar, reagimet  
Në faqen 18-19

**ME ÇANTA NJESJ**  
Tentuan të kalonin kufirin me 125 kg drogë, arrestohen 7 shqiptarët  
Në faqen 9

**PAS DËRBIT**  
Stuhi bardheblu, Ze Maria i ka orët e numëruara, braziliani mund të shkarkohet  
Në faqen 22

### DISKUTIMET NE TEATER DOSSIER NGA DASHNOR KALOÇI



**Denoncimet në Teatër: Ali Oseku, i vetmi që del me maksipallto si Napoleon Bonaparti**  
Në faqen 10-11

Prof. dr. Kim Drasa: Shkaktarët e çrregullimeve seksuale te femrat

## "Disfunksioni seksual te burrat, shkatërrues"

Ylli Merja: Infeksionet e bajameve, si t'i kuroni me bimë

NGA VOLTIZA DURO  
Kur njëri nga partnerët seksualë ka ulje dhe çrregullime të funksionit seksual, do të ndikojë patjetër negativisht edhe tek partneri/ja. Ky është konkluzioni kryesor i studimit të paraqitur në Las Vegas nga prof. dr. Kim Drasa. Ky



i fundit prej kohësh paraqet studime dhe metoda mjekimi për të ruajtur lidhjen intime të familjeve të shëndosha moralisht, të cilat nuk kanë tradhti bashkëshortore. Në studimin në Massachusetts, 52% e burrave, nga moshë 40-70 vjeç, kishin pasur ED ...  
Suplement

Në faqen 22

## DOSJA "RRAJA" ARRESTIMI

Merren në pyetje motra, nëna e 25-vjeçares dhe të afërm të ish-të dashurit

# Përballja mes të rinjve nxjerr zbuluar djalin e deputetit

*Dita e dhunimit, dëshmitë e  
Malokut dhe Rrajës kontradiktore*

KRUJË

Ballafaqimi mes dy të rinjve Rexhep Rraja dhe 25-vjeçares Xhisela Malokut ka qenë prova përfundimtare që ka bindur prokurorinë e Krujës për të kërkuar arrestimin e djalit të deputetit socialist Rrahman Rraja. Dy të rinjtë janë ballafaquar në komisariatit e Krujës për orë të tëra, por dëshmitë e tyre kanë qenë kontradiktore për sa i përket ditës së dhunimit të 25-vjeçares. E kërkuar nga prokurorja e çështjes, Xhisela Maloku dëshmoi rreth një orë në prokurorinë e Krujës. Fill pas saj në prokurori është paraqitur ish-i dashuri i saj të cilin ajo e ka denoncuar për përndjekje dhe dhunë, Rexhep Rraja, i cili po ashtu është marrë në pyetje. Djali i deputetit Rraja është pyetur në lidhje me pretendimet e vajzës. Ata kanë dhënë data dhe orë të ndryshme për vendndodhjen e tyre. Me sa duket edhe administrimi i akt ekspertimit teknik të telefonave të dy të rinjve ka mbështetur dëshminë e Xhisela Malokut. Në pyetje janë marrë nëna dhe motra e 25-vjeçares si dhe një mikeshë të Xhisela Malokut, gjithashtu, në pyetje janë marrë edhe të afërm të Rexhep Rrajës që po ashtu kanë dhënë deklaratat të ndryshme. Burime të besuara pohojnë se nëna e Xhiselës mohon të ketë pasur djeni për problemet e të bijës, të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe shoqja e saj. Ndërsa e motra, ka pohuar për oficerët e policisë gjyqësore, se ishte në djeni që Xhisela kishte debate me të dashurin e saj, por vetëm në një rast ka pasur zënkë mes tyre. Por prokuroria pretendon se ka krijuar bindjen se Rexhep Rraja ka konsumuar aktin penal të përndjekjes duke ushtruar



E dhunuara, Xhisela Maloku

dhunë, çka solli edhe kërkesën në gjykatën e Krujës për arrestimin e tij. Më herët psikologja Anjeza Kallaku, e cila ka qenë e pranishme ditën kur e reja tërhoqi kallëzimin ka treguar se e ka telefonuar në orën 10 të natës oficeri policisë së Fushë-Krujës, që ajo të asistonte në tërheqjen e një padie dhune nga 25-vjeçarja me inicialet Xh.M. "Gentian Çitozi më ka marrë në orën dhjetë e çerek të natës. Më tha që kishte një rast dhune dhe më pyeti a mund të vija për një shtetase. I thashë që isha me pushime verore, por m'u lut që të vija sepse nuk kishin mundësi që të gjenin një psikologe tjetër. Jam shoqëruar në rajon me babain tim. Në komisariat ishte Gentian Çitozi dhe një zotëri që po përfundonte dëshminë e tij. Nuk e njihja se kush ishte, më pas mora vesh që ishte ish-i dashuri i vajzës. Vajza erdhi më pas", tregon psikologja. Psikologja thotë se nuk ka informacion se përse vajza u tërhoq nga denoncimi, të cilin e kishte dorëzuar në të njëjtin ditë, por paradite. Vajza kishte deklaruar se ishte pajtuar. "Mua m'u bë

prezent si çështje kalimtare. Thjesht që vajza ka kallzuar dhe tani po e tërheq padinë. Vajza më tha që ishte penduar. Nuk konstatova shenja frike, madje më dukej në kushte normale. E këshillova që të kishte kujdes. Nuk kishte shenja dhune, por nuk mund të them më shumë", thekson psikologja. I pranishëm ditën kur 25-vjeçarja tërhoqi kallëzimin ka qenë edhe avokati Elton Frangu. Më herët ai tregoi se është thirrur nga oficeri i policisë, Gentian Çitozi. Frangu thekson se është thirrur pas orës 22:00 të mbrëmjes, ndërsa për datën thotë se nuk i kujtohet saktësisht, përveçse ka qenë muaji korrik. Avokati shpreh se i është kërkuar të shkojë në komisariatit e Fushë-Krujës nga oficeri i policisë, Gentian Çitozi, pasi një vajzë kërkonte të tërhoqte një kallëzim penal të bërë mëngjesin po e asaj dite. Ai shton se në raste të tilla nuk është e nevojshme prania e avokait, por ka vajtur në komisariat për të mbrojtur interesat e vajzës. "I thashë të ketë kujdes, pasi ka bërë një kallëzim penal dhe

mund të mbash përgjegjësi për dëshmi të rreme", është shprehur avokati. Ndërkohë në dëshminë e dhënë në komisariatit e saj, Xhisela tregon se është njohur me djalin e deputetit në vitin 2012 dhe ka qenë e lidhur me të deri në vitin 2017. 25-vjeçarja rrefen se pas ndarjes me djalin e deputetit të PS, kanë filluar konfliktet. Ajo tregon se kallëzimin në polici e ka bërë për ngjarjen e ndodhur më datë 19.07.2018, ku sipas saj është takuar me Rexhep Rrajën dhe pas një debati me tone të ashpra në makinën e tij, nën kërcënimin e armës ai e ka dërguar në një hotel. Në dhomë ajo tregon se është dhunuar nga ish-i dashuri, është djegur me cigare në këmbë prej tij dhe është goditur në kokë me qytën e pistoletës. Si pasojë e dhunës së ushtruar, vajza thotë se ka humbur ndjenjat dhe nuk kujton më gjë.



### TË AFËRMIT

Në pyetje janë marrë nëna dhe motra e 25-vjeçares si dhe një mikeshë të Xhisela Malokut, gjithashtu, në pyetje janë marrë edhe të afërm të Rexhep Rrajës që po ashtu kanë dhënë deklaratat të ndryshme. Burime të besuara pohojnë se nëna e Xhiselës mohon të ketë pasur djeni për problemet e të bijës, të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe shoqja e saj. Ndërsa e motra, ka pohuar për oficerët e policisë gjyqësore, se ishte në djeni që Xhisela kishte debate me të dashurin e saj, por vetëm në një rast ka pasur zënkë mes tyre.



## Berisha publikon listën e diplomave e certifikatave të oficerit Nuhu

Ish-krumministri Sali Berisha ka publikuar një listë të gjatë diplomash e certifikatash të ish-oficerit të policisë Emiliano Nuhu. Reagimi i Berishës vjen në përgjigje të deklaratave të kryeministrit Rama që e konsideroi një "horr" ish-oficerin. "Të dashur miq, oficeri i Emiliano Nuhu, të cilin kryepërdhunesi Edvin Kristaq Rama e quajti horr, është një nga herojtë e vërtet të Policisë së Shtetit. Këtu më poshtë keni nëntë diplomat, certifikatat, vlerësimet shqiptare dhe ndërkombëtare të oficerit Emiliano Nuhu, një hero i vërtet para ligjit dhe në detyrat e tij, të cilin Edvini e quan horr sepse me dëshminë e tij tronditëse u faktoi shqiptarëve dhe botës se Rexhep Rraja, biri kriminel në kërkim i pushtetit, është një sadist, përdhunes kurse Edi Rama është kryepërdhunes i rrethuar nga horra dhe përdhunes ministra, deputetë, komisarë, prokurorë, gazetarë, psikologë si Faqez Droga, Tulant Bega, Geron Velia... etj", -thuhet në postimin e plotë të ish-krumministrit Sali Berisha.

**EKSPERTIZA**

Mjekësia ligjore ka dorëzuar më 27 shtator në prokurorinë e Krujës aktin e ekspertimit të Xhisela Malokut duke vlerësuar se ajo ka dëmtime fizike të cilat klasifikohen si rrahje dhe për të cilat ligjërisht, jepet raport deri në 9 ditë. Më konkretisht, e reja ka gërvishje në shpatullën dhe në kofshën e djathtë, disa prej të cilave të shkaktuara edhe me mjete prerëse.



## Policia: Ndalohet Rexhep Rraja, akuza e ngritur ndaj tij "Përndjekja"

Policia e Durrësit njofton përmes një njoftimi për shtyp, arrestimin e djalit të deputetit Rrahman Rraja, Rexhep Rraja, 24-vjeçari i akuzuar për dhunimin e Xhisela Malokut. Në njoftimin për shtyp, bëhet e ditur se e vetmja veprë penale që rëndon ndaj djalit të deputetit, është ajo e përndjekjes, parashikuar në nenin 121/a të Kodit Penal. "Specialistët e Komisarariatit të Policisë Krujë në bashkëpunim me Forcat Operacionale të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës bënë kapjen me qëllim ekzekutimin e Urdhrit të Prokurorisë Krujë mbi bazën e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, nr.189 dt. 29.09.2018, e cila ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" për shtetasin Rexhep Rraja 24 vjeç, banues në Krujë. Ai akuzohet për veprën penale "Përndjekja" parashikuar në nenin 121/a të Kodit Penal.

Materialët i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për veprime të mëtejshme", thuhet në njoftimin e policisë.

I riu u ndalua pranë një biznesi makinash me qira në Rinas

# Arrestohet Rexhep Rraja, djali i deputetit të PS

## Akuzohet se dhunoi dhe përndoqi 25-vjeçaren Xhisela Maloku

Pas lëshimit të urdhërave restit nga Gjykata e Krujës për djalin e deputetit të Partisë Socialiste, Rrahman Rraja, policia ka ekzekutuar ditën e djeshme vendimin duke vënë në pranga Rexhep Rrajën. Gjykata e Krujës dha dy ditë më parë masën e sigurisë "Arrest me burg" në mungesë për të riun e akuzuar për ushtrim dhune dhe përndjekje të ish-të dashurës së tij, 25-vjeçares Xhisela Maloku. Mësohet se ka qenë prokurorja Mirela Kapo, e cila ka kërkuar nga gjykata e Krujës arrestimin e Rrajës ndërsa gjyqtarja Enkelejda Hoxha ka pranuar kërkesën e saj dhe vendimi është ekzekutuar nga punonjësit e policisë, ndërsa ai ndodhet në ambientet e komisarariat. Bëhet me dije se Rexhep Rraja është arrestuar paraditen e djeshme pranë një biznesi makinash me qira në Rinas. Në momentin e arrestimit nga policia, i riu nuk ka bërë rezistencë. Nga ana tjetër, Mjekësia ligjore ka dorëzuar më 27 shtator në prokurorinë e Krujës aktin e ekspertimit të Xhisela Malokut duke vlerësuar se ajo ka dëmtime fizike, të cilat klasifikohen si rrahje dhe për të cilat ligjërisht, jepet raport deri në 9 ditë. Më konkretisht, e reja ka gërvishje në shpatullën dhe në kofshën e djathtë, disa prej të cilave të shkaktuara edhe me mjete prerëse. "Dërmishjtja në shpatullën e djathtë dhe ekimozat në pulpën dhe kërcirin e majtë, janë shkaktuar me mjet mbretës. Dërmishjtja e vërejtura në kofshën e djathtë, janë shkaktuar nga veprimi i faktorëve termikë, siç mund të jetë edhe cigarja. Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve, të cilat sjellin si pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punën në masën prej 9 ditësh", thuhet në raportin e mjekëve ligjorë. Ekspertimi është dorëzuar në organin e akuzës në Krujë për tu administruar në dosjen e procedimit penal të nisur ndaj shtetasit Rexhep Rraja, për akuzën e përndjekjes.

**HETIMI**

Dosja hetimore mësohet se është hapur pas kallëzimit të bërë nga Xhisela Maloku në datën 26 korrik 2018, pasi vajza ka pretenduar se është dër-



Rexhep Rraja, djali i deputetit të PS

**VENDIMI**

Prokurorja Mirela Kapo ka kërkuar nga gjykata e Krujës arrestimin e Rexhep Rrajës, ndërsa gjyqtarja Enkelejda Hoxha ka pranuar kërkesën e saj dhe vendimi është ekzekutuar nga punonjësit e policisë, ndërsa ai ndodhet në ambientet e komisarariat. Bëhet me dije se Rexhep Rraja është arrestuar paraditen e djeshme pranë një biznesi makinash me qira në Rinas. Në momentin e arrestimit nga policia, i riu nuk ka bërë rezistencë.



guar me forcë në hotel dhe është dhunuar nga ish-i dashuri Rexhep Rraja. Veç këtij procedimi të nisur ndaj djalit të deputetit të PS Rrahman Rraja, mësohet se në prokurorinë e Krujës, është regjistruar edhe një dosje e dytë për këtë çështje, ndaj oficerit Gentian Çitozi për veprën penale shpërdorim detyre. Procedimi ndaj oficerit Çitozi është hapur pikërisht mbi bazën e pretendimeve të ngritura nga Xhisela Maloku për tërheqjen e kallëzimit që kishte bërë për dhunë fizike ndaj saj. Në procesverbalet e marrjes në pyetje të Çitozit në datat 23 korrik dhe 3 gusht, nënkomisari i pezulluar thotë se vajza u tërhoq me vullnetin e saj, por nuk jep shpjegime të qarta se përse i pranishëm në stacion ishte edhe ish-i dashuri i saj. "Rreth orës 14:00 jam njoftuar nga salla operative e Krujës, pasi kjo e fundit ishte lidhur me sallën operative të komisarariatit numer 3 në Tiranë, nga e cila kishte marrë kallëzimin që Xhisela Maloku kishte paraqitur për shtetasin Rexhep Rraja, duke pretenduar se ishte përndjekur, dhunuar, sharë dhe ofenduar prej tij. Për rastin jam njoftuar nga salla, me qëllim që të verifikojta atë dhe të kryeja veprimet procedurale, të cilat do të ishin të

nevojshme për hetimin. Kam njoftuar shtetasin Rexhep Rraja, i cili është paraqitur pranë stacionit të policisë Fushë Krujë, rreth orës 20:00 i shfaqur me kallëzuesen Xhisela Maloku, së bashku me dy avokatë dhe një psikologe. Me kërkesën e tyre kam përfunduar proces verbalin e heqjes dorë nga kallëzimi që kishte bërë pranë komisarariatit të policisë nr.3 Tiranë", thuhet në procesverbal. Qëndrim të ndryshëm nga Çitozi, i pezulluar nga detyra mban ish-komisari Emiliano Nuhu. Ai pretendon se u kërcënuar me armë në praninë e njerëzve të veshur me pushtet, me qëllim që të mos firmoste arrestimin e djalit të deputetit. Ishte pikërisht Nuhu, i cili pak ditë më parë bëri publik dhunimin e vajzës. Ai akuzoi policinë për neglizhencë si dhe tregoi se ishte kërcënuar me armë në praninë të deputetit Taulant Balla. Në lidhje me këtë ngjarje Nuhu deklaroi për "News24" se disponon fakte dhe prova, të cilat do i bëjë publike vetëm në gjykatë. Ai akuzoi institucionet përgjegjëse se po tentojnë të të manipulojnë ngjarjen. Ai përsëriti se është kërcënuar nga vëllai i deputetit Rrahman Rraja në praninë të Taulant Ballës, që të mos merrte dëshminë e të dhunu-

arës Xhisela Maloku. Nga ana tjetër, prokurorria ka sekuestruar edhe kamerat e hotelit ku vajza pretendon se është dërguar me forcë dhe është dhunuar nga shtetasin Rexhep Rraja.

Më herët Policia e Shtetit doli në një deklaratë për mediat dhe bëri të ditur pezullimin e oficerit të policisë Gentian Çitozi, i cili nuk ka marrë denoncimin e vajzës në praninë të Rexhep Rrajës. Në deklaratë drejtoresha e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Aida Hajnaja tha se policia ka vazhduar hetimet pavarësisht tërheqjes së kallëzimit nga ana e vajzës, madje është referuar edhe në prokurorinë si rast. "Oficeri i policisë Çitozi, nuk ka vepruar sipas ligjit, sepse ka qenë prezent edhe Rexhep Rraja dhe oficeri është pezulluar. Më pas është marrë kallëzimi i vajzës. Pavarësisht kërkesës së shtetasës që është tërhequr nga kallëzimi, policia ka vazhduar me çështjen. Çdo masë e ndalimit nuk është kompetencë e policisë. Policia nuk e ka ndaluar hetimin, por e ka referuar atë në prokurorinë", tha Policia e Shtetit.



MAJLINDA BREGU

**ISH-DEPUTETE**

"Pas arrestimit të dhunuesit të Xhisielës, në radhë për gjyq, hetim e shkarkim duhet të jenë ata që flenë gjumë rehat natën se vendin e punës e kanë të sigurt vetëm kur nuk cenojnë të fuqishmit. Nëse strukturat e Mekanizmit të Dhunës nuk marrin dot masa për parandalimin dhe luftën ndaj dhunës, atëherë parlamenti le të marrë inisiativën për marrjen e masës ndaj tyre", - tha dje, ish-deputetja e PD-së.



EDI PALOKA

**NENKRYETAR PD**

"Po me ata që penguan drejtësinë deri më sot çdo të bëhet? Po me ata që dhe këto ditë vazhdojnë të kërcënojnë viktimat dhe sulmojnë denoncuesit e krimi, duke filluar nga kryehorri? Asgjë nuk do të ndodhë nëse nuk i hedhim në plehra, atje ku e kanë vendin..."-ngriti dje, pyetjet nënkryetari demokrat Edi Paloka.



FLAMUR NOKA

**DEPUTET I PD**

"Nuk mbulohet dielli me shoshë Edvin. Prokurorja Politike e Partisë nuk mund të të shpëtojë faqen ty e bandës tënde. Pse nuk e arrestoi përdhunuesin kamikazja jote atëherë kur ndodhi përdhunimi, por tani që opozita e dha alarmin se krimi me pushtet dhunon e përdhunon e "drejtësia e re" joja mbyll sytë dhe nuk e ndëshkon???", u shpreh dje, Noka, duke kërkuar largimin e Ramës.

Opozita akuzon kryeministrin: Mbrojti përdhunuesin dhe deputetët e tij

# PD: Arrestimi i djalit të deputetit të PS, truk për të mbyllur skandalin

"Skenar mafioz që ligji të mos zbatohet"

Partia Demokratike e cilësoi të pamjaftueshëm arrestimin e djalit të deputetit socialist Rrahman Rraja. Në një reagim të saj, PD shprehet se: "arrestimi i djalit përdhunues të deputetit të PS është prova se gjithë vëmendja e Edi Ramës këto dy muaj dhe e prokurorisë nën urdhrat e tij ka qenë për të mbrojtur përdhunuesin dhe zyrtarët e deputetët e tij, të përfshirë në krim". Sipas demokratëve, "arrestimi i djalit të pushtetarit erdhi vetëm pas bërjes publik të rastit nga nënkomisar Emiljano Nuhu, duke provuar vërtetësinë e dëshmisë së tij". Por, thuhet më tej, në qëndrimin e grupit të deputetëve demokratë, arrestimi i djalit të deputetit të Edi Ramës vetëm nën presionin e lartë publik, është i pamjaftueshëm dhe një truk për t'i vënë kapak një skandali më të madh politik: përfshirjes direkte të disa prej pushtetarëve më të lartë të vendit në krimin e mbulimit të torturimit të vajzës nga djali i deputetit të Edi Ramës. "Arrestimi i djalit të deputetit të PS Rrahman Rraja është një truk, sepse, bashkë me të, para drejtësisë duhet të ishte Rrahman Rraja, Taulant Balla dhe Artur Bushi, të pranishëm në kërcënimin me pistoletë në kokë të nënkomisar Emiljano Nuhut për të mbyllur çështjen. Arrestimi i djalit të deputetit të PS është një truk për të mashtruar opinionin publik, sepse në burg, bashkë me të, duhet të ishin shefat e komisarivateve që, gjatë gjithë këtyre muajve, mbajtën anën e kriminelit dhe jo të vajzës së dhunuar apo të policit



AGRON SHEHAJ

Deputeti i Partisë Demokratike, Agron Shehaj tha se burime të tij të besueshme bëjnë me dije se hetuesit me urdhrë të Ramës kanë përgatitur një raport ku e nxjerrin Xhisiela Malokun me probleme mendore dhe halucinacione, në mënyrë që të rrezohet dëshmia e saj.



OERD BYLYKBASHI

Përmes një postimi në 'Facebook', deputeti i PD, Oerd Bylykbashi tha se kryeministri Edi Rama e quajti horr dhe kërcënoi oficerin e policisë së Krugës Emiliano Nuhu, i cili është trajnuar nga agjensitë e specializuara amerikane. Bylykbashi tha se banda që qeveris sot duhet shpërrur.



SHEZAI RROKAJ

Deputeti i LSI-së Shezai Rrokaj u shpreh dje, arrestimi i djalit të deputetit socialist tregon se Rexhep Rraja duhej ndaluar qysh në momentin e denoncimit dhe se oficeri Emiljano Nuhu nuk është horr sikurse tha kryeministri. "Enigma e mosveprimit nga ana e policisë u kuptua qartë se ka vetëm një njeri që komandon gjithçka dhe ky është kryeministri", -tha Rrokaj.

të kërcënuar", theksohet në qëndrimin e Partisë Demokratike, për ngjarjen

e ditëve të fundit. Sipas demokratëve, "arrestimi i djalit të deputetit të PS



**"Ngjarja u fsheh nga strukturat e shtetit"**

LSI dënon qëndrimin e kreut të qeverisë: Ta hetojë prokuroria

Lëvizja Socialiste për Integrim dënon rreptë qëndrimin e kryeministrit dhe qeverisë si promovues dhe mbrojtës të dhunës dhe krimi të vendit.

Në një reagim të saj, LSI shprehte se "ngjarja shumë e rëndë e dhunimit të një vajze të thjeshtë në Fushë Krujë dhe fshehja e saj nga strukturat qeveritare që u bënë palë me deputetët e inkriminuar në të është provë se shteti është kapur totalisht nga krimi". LSI kërkon që prokuroria të largohet nga roli i shërbëtores me shërbim të qeverisë por të hetojë me themel dhe të çojë përpara drejtësisë të gjithë personat e përfshirë në fshehjen dhe manipulimin shtetëror të ngjarjes qofshin këta kryeministra, deputetë, pjesëtarë të policisë, prokurorë etj. "Të hetohen të gjithë veprimet e mosveprimet që sollën në këtë trajtim kriminal të çështjes duke luajtur në mënyrë flagrante me jetën dhe integritetin e një vajze të re të pambrojtur. Të hetohet sjellja skandalozë e shtetit në raport me nënkomisarin Emiljano Nuhu dhe roli i çdo personi me detyrë shtetërore që ka influencuar negativisht e ka penguar në ushtrimin e detyrës të z.Nuhu", -thuhet në reagim. "Të hetohet nga prokuroria shpërdorimi i detyrës nga kryeministri Edi Rama që ka kërcënuar e kanosur publikisht z.Emiljano Nuhu vetëm sepse ai denoncoi të vërtetën e fshehur nga shteti. LSI është e vendosur të luftojë deri në fund për zbardhjen e këtyre të vërtetave, të cilat janë tashmë para syve të çdo shqiptari", - thuhet në deklaratën e LSI-së.





PETRIT VASILI

**KREU I GRUPIT PARLAMENTAR TE LSI**

"Natyrshtëm horri i vetëm mbetet të jetë vetë kryeministri, që shpërdoroi poshtërsisht karrigen për të bërë shantazh dhe presion në mbrojtje të krimit dhe përdhunimit të të tije dhe nuk e mbrojt denoncuesin e krimit të përdhunimit, por e kërcënoi. A ka horrlëk më të madh? Mbyllje gojën kryeministër dhe mos fol më se qelbe dynjanë!", -tha Vasili.



ELISA SPIROPALI

**DEPUTETE E PS**

"Çilido që e ka ndjekur debatin për rastin e vajzës së dhunuar, duhet të lexojë deklaratën e Partisë Demokratike për ndalimin e djalit të deputetit nga policia. Si mund ta thoshin më mirë, me gojën e tyre, që atyre s'u intereson drejtësia po politika?! S'u intereson fati i drejtësisë për vajzën, po fati i fabrikimit për Taulant Ballën", -tha dje, Spiropali.



TAULANT BALLA

**KREU I GRUPIT PARLAMENTAR TE PS**

"Nuk më çudit asgjë që ata thonë, bëjnë, nxisin, thurin apo inskenojnë për të më baltosur e cenuar mua. Siç, në fakt, ishte shpifja e radhës në qershor me paratë e kapura nga Policia e Shtetit, kur në fund i humbur doli Lulzimi, të cilin do t'i duhet të paraqitet më datë 10 tetor në gjykatë si i akuzuar", tha dje, deputeti i PS-së.



Kreu i Grupit Socialist: Përpara ligjit jemi të barabartë të gjithë

# Dhunimi i Xhisela Malokut, Rama: Prokuroria t'i shkojë deri në fund

*"PD po vijon yrryshin e politikës së dëshpëruar"*

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama shprehu dje, mbështetjen për prokurorinë, pas arrestimit të djalit të deputetit socialist Rrahman Rraja për dhunimin e 25-vjeçares Xhisela Maloku. Përmes një statusi në rrjetin social "Twitter", Rama inkurajoi prokurorinë të mos ndalet deri në fund, por nuk kurseu as akuzat për opozitën, duke u thënë se u bënë mburojë e të kërkuarve nga drejtësia dhe sot po rihumojnë vajzën për politikë. "Ndryshe nga ata që dje u bënë mburojë e të kërkuarve nga drejtësia duke i hapur luftë prokurorisë dhe sot po rihumojnë vajzën për politikë, ne mbështesim drejtësinë e barabartë për të gjithë gjithmonë. Inkurajoj prokurorinë të mos ndalet deri në fund #eGjithëVëmend-japërVajzën", shkroi kreu i qeverisë, dje. Më pas, rreth darkës, kur zërat reagues u shtuan për këtë ngjarje, Rama ka shkruar një tjetër koment. "E kanë kapur vajzën si të ishte një dru për të shembur portën dhe vijojnë me yrryshin e politikës së tyre të dëshpëruar. Asnjë fjalë mbështetjeje për prokurorinë. Përkundrazi, veç baltë pa asnjë fre tanimë". Edhe njëherë shqiptarët e bëjnë qartë dallimin. #eGjithëVëmend-japërVajzën", u shpreh më tej, kryeministri Rama.



**KRYEMINISTRI**

"E kanë kapur vajzën si të ishte një dru për të shembur portën dhe vijojnë me yrryshin e politikës së tyre të dëshpëruar. Asnjë fjalë mbështetjeje për prokurorinë. Përkundrazi, veç baltë pa asnjë fre tanimë", -tha kreu i qeverisë.

dhe Partinë Socialiste! E di që prej vitesh tashmë jam halë në sy për Saliun, Lulin dhe ca shërbëtorëve ordinerë të tyre, se të them të drejtën ka edhe deputetë të PD që janë njerëz normale", tha Balla, dje. "Nuk më çudit asgjë që ata thonë, bëjnë, nxisin, thurin apo inskenojnë për të më baltosur e cenuar mua. Siç, në fakt, ishte shpifja e radhës në qershor me paratë e kapura nga Policia e Shtetit, kur në fund i humbur doli Lulzimi të cilin do t'i duhet të paraqitet më datë 10 tetor në gjykatë si i akuzuar. Por kjo deklaratë sot më ka çuditur pak se është e gjitha në mbështetje të qasjes sonë dhe deklarata konfirmon se Luli dhe PD vajzën e dhunuar e duan thjeshtë mish për top në luftën politike!", vijoi më tej Balla.

**"Drejtësia për vajzën është mbi gjithçka"**

Deputetët e PS: Na vjen mirë që prokurorja e çështjes është grua

Grupi i Grave Deputete të Partisë Socialiste shprehu dje, mbështetjen për prokurorinë në hetimin deri në fund të së vërtetës për dhunimin e Xhisela Malokut. Në një deklaratë për mediat, grupi i grave deputete të PS-së u shprehën: "Na vjen shumë mirë që prokurorja e çështjes është një grua, e cila sot ka të gjithë solidaritetin tonë në kryerjen e detyrës si edhe inkurajimin tonë të plotë, për t'i shkuar deri në fund çështjes në fjalë. Duke i rezistuar çdo ditë prej kohësh tanimë, vulgut politik e mediatic dhe duke treguar guxim e vendosmëri në ndarjen e drejtësisë nga politika, prokuroria po jep në vijimësi sinjale shumë inkurajuese për shqiptarët që duan drejtësi".



"I bëjmë përsëri thirrje kolegeve deputete të opozitës të ndikojnë që të ndalet dhunimi publik i vajzës për motivet e politikës së dëshpëruar opozitare. Po ashtu u shprehim atyre keqardhjen për deklaratat e akuzat të ulëta, që shkojnë në drejtim krejt të kundërt me interesin e Xhiselës dhe të drejtësisë për të. Për ne drejtësia për vajzën është mbi gjithçka. Për ne ligji është mbi gjithçkënd", -thuhet në deklaratën e deputeteve socialiste.

**Kreu i Grupit Parlamentar**  
Kryedeputeti socialist Taulant Balla, i cili u vu në qendër të akuzave të opozitës reagoi po ashtu dje, pas arrestimit të djalit të deputetit Rraja. "Përpara ligjit ne jemi të gjithë të barabartë përveç Saliut, Lulit dhe atyre që i shpëtuan

prokurorisë, falë Saliut dhe Lulit që nuk i zbatonin urdhrat e organit të akuzës. Barazia para ligjit për ne nuk është slogani po parim themelor në fjalën tonë, në reformat dhe qëndrimet tona. Ndalimi i djalit të de-

putetit na ndan qartë edhe njëherë nga ata që kemi përballë! Sepse jo vetëm nuk e pengojmë prokurorinë dhe as protestojmë kundër saj, po e mbështesim plotësisht", deklaroi Balla. Sipas tij, "drejtësia duhet ta thotë fjalën e saj deri në fund dhe shpresoj shumë që edhe autorët dhe heroi i Babale dyshit të marrin atë që ju takon nga organi i akuzës". Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së u detyrua të reagojë sërisht, pas akuzave të opozitës. "E përshëndes deklaratën e partisë babalokraktike (PD), sepse nxjerr plotësisht zbuluar qëllimin e tyre që nuk ka qenë e nuk është fare drejtësia për vajzën e dhunuar, por lufta e pistë politike me mua dhe Partinë Socialiste!



Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit material kombëtar për venienë në funksionim të databazës shtetërore NISA, Dhomë Kombëtare e Noterisë (DH.K.N.) fton Operatorët Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në kete procedure. Dokumentat e projektit mund të terhiqen perkurndretj pageses prej **10.000 leke**, prane Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tiranë, Shqipëri. Propozimet do të pranohen brenda dates **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

# INVESTIMET KRYEMINISTRI

Nisin punimet për Delvinë-Kardhiq, kreu i qeverisë: Tiranë-Sarandë vetëm për 3 orë

## Rama: Do ndërtojmë rrugë europiane, jo udhëkryqe e rrugë ku ecën edhe lopa

"Gjirokastra doli nga lista e rrezikut të UNESCO-s"

Darina Tanushi

**N**e do ndërtojmë rrugë europiane", u shpreh dje, kryeministri Edi Rama, gjatë nisjes së punimeve për ndërtimin e rrugës së re kombëtare Delvinë-Kardhiq. Ai tha se kjo qeveri nuk do të ndërtojë "rrugë që janë edhe udhëkryqe, janë edhe për të ecur me makinë, janë edhe për të ecur lopa, janë edhe për të shitur mallra, janë edhe për të lidhur qytete. Këto lloj rrugësh, ne duam t'i arkivojmë në të shkuarën". Kryeministri tha se qeverisë iu desh një mandat për të hequr borbhet e lëna nga qeveria paraardhëse. "Ne nuk do ta konkurrojmë dot qeverinë paraardhëse për numrin e tenderëve të bëra, por ama edhe për tenderin e bërë për rrugën që jemi këtu sot, për një segment ku filloi puna dhe u la rrugëve, kemi financuar ne, më mbraja. Asnjë lek nuk u dha nga qeveria e mëparshme. U zhytën ata që punonin këtu në borxhe me bankën, si gjithë kompanitë e tjera. Sot, financa e konsoliduara na e japin këtë mundësi dhe na japin mundësinë të kemi dy programe paralele. Një program nga buxheti i shtetit direkt, siç është ky këtu dhe një program me partneritetin publik - privat, siç po bëjmë Rrugën e Arbrit, siç po shpejti fillojmë segmentin Thumanë - Kashar, Milot - Ballëdren, segmentin tjetër Oriku - Llogora", deklaroi Rama, më tej. Sipas Ramës, "gjitë gjatësia e rrugës është përfshirë në gjithë ato bilancet e 10 mijë kilometrave rrugë që ishin në fantazitë e Saliut. E vërteta është që jo 10 mijë kilometra rrugë, por edhe kjo ishte në inventarin e rrugëve të lëna rrugëve". Më tej kryeministri tha se përfundimi i kësaj rruge do të shkurttojë me një orë lidhjen e Tiranës me Sa-



### KRYEBASHKIAKJA E LSI-SË

Kryeministri Edi Rama, gjatë inspektimit të ndryshimeve të bëra në Gjirokastrë është shoqëruar nga deputeti i qarkut Bledi Çuçi dhe kryetarja e bashkisë së LSI-së, Zamira Rami. Edhe më herët, Rami ka lëshuar sinjale bashkëpunimi me mazhorancën socialiste.

### Ish-deputeti i PD-së sulmon kryetarin: Kam lobuar për të

## Astrit Patozit: Misioni i Bashës në politikë është për të bërë para

**N**jë nga ish-drejtesit më të lartë të Partisë Demokratike, Astrit Patozi akuzoi kreun e PD-së Lulzim Basha se ka hyrë në politikë për t'u pasuruar. Ai tha se ka lobuar për Bashën në PD, por sipas tij, kryedemokrati ka treguar se nuk ka vizion për politikë. Ish-nënkryetari i Partisë Demokratike, Astrit Patozi, në emisionin "Provokacija" ka rrëfyer se me kreun aktual të Partisë Demokratike, Lulzim

Bashën ka pasur marrëdhënie normale dhe se e ka mbështetur atë në hapat e parë në politikë, duke lobuar në radhët e demokratëve për rritjen e profilit politik të pasardhësit të Sali Berishës në selinë blu. "Me Lulzim Bashën kam pasur marrëdhënie normale. E kam pranuar që në fillim kur ka ardhur, madje kam bërë lobim për të. Po Basha, gjatë gjithë jetës së tij politike, ka treguar se nuk ka vizion misionari", u shpreh Astrit Patozi. Më tej gjatë

bisedës, ai ka deklaruar se Basha ka hyrë në politikë vetëm për të bërë para. Sipas tij, misioni i vetëm i Lulzim Bashës është pasurimi dhe jo ringritja dhe rikthimi i Partisë Demokratike në pushtet. "Basha ka hyrë në politikë për të bërë para, këtë mision ka ai", u shpreh Patozi. Gjithashtu, ish-nënkryetari i Partisë Demokratike ka thënë se fajëson Bashën, për gjenjen ku ndodhet PD-ja, citon Ekskluzive.al.

randën që do të bëhet për 3 orë. **GJIROKASTRA** Kryeministri ishte dje, edhe në ceremoninë inauguruese të përmbylljes fazës së parë të restaurimit të Pazirit të Gjirokastrës. Gjatë fjalës së mbajtur atje ai tha: "Kur sheh rezultatet e kësaj pune, nuk mund të mos mendosh për një moment se në vitin 2013, kur ne morëm detyrën, Gjiroka-

stra ishte në listën e pasurive botërore në rrezik dhe Shqipëria rrezikonte të merrte nga UNESCO një vulë turpi për mungesë të plotë vëmendjeje dhe përgjegjësi ndaj një trashëgimie kulturore si kjo, por jo vetëm si kjo këtu, por edhe si Berati, që është pjesë e trashëgimisë kulturore botërore". "Natyrshë që, duke thënë këto, nuk jam aspak duke u përpjekur të them se

çka kemi bërë mjafton, por nuk ka diskutim se, qysh nga 2013-ta deri sot kanë kaluar vetëm 5 vjet, por, në fakt, duket sikur ka kaluar një epokë e tërë, pasi Gjirokastra është nxjerrë nga lista e rrezikut eminent të UNESCO-s. Gjirokastra është kthyer në qendër të vëmendjes së qeverisë për sa i përket trashëgimisë kulturore", theksoi Rama. Ai shtoi se "Gjirokastra ka parë investime të kryera në 5 vjet që janë më



### Kreu i shtetit takon kryeministrin e Kosovës, në Nju Jork

## Meta-Haradinaj: Vendosmëri për ta çuar përpara axhendën euroatlantike

**P**residenti i republikës Ilir Meta është takuar në Nju Jork me kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinaj. "Pata kënaqësinë të takohesha në Nju Jork me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, pas kthimit të tij nga Uashingtoni dhe para nisjes së tij në Kosovë", ka shkruar presidenti në Facebook. Ndërsa Haradinaj ka theksuar se gjatë bisedës u konfirmua vendosmëria e dy vendeve për ta çuar përpara axhendën euroatlantike. Kreu i qeverisë së Kosovës gjatë takimit ka theksuar se Kosova dhe Shqipëria janë në të njëjtin kurs të përcaktimit euro-atlantik dhe miqësisë së përhershme me Amerikën. Gjatë takimit të dy liderët rikonfirmuan se vendosmëria e Shqipërisë dhe Kosovës për të çuar përpara reformat, mbetet e palëkundur. Po kështu Presidenti Meta pati takim edhe me drejtnuesin e Këshillit Shqiptaro-Amerikan, Haxhi Dauti. Presidenti Meta e falënderoi Dautin për kontributin e dhënë nga ana e tyre për çështjen shqiptare dhe kryesisht për zhvillimin e proceseve demokratike në Maqedoni. Një tjetër takim, kreu i shtetit e pati me Vehbi Bajramin, botuesin e gazetës shqiptaro-amerikane "Illyria" si dhe me përfaqësues të diasporës shqiptare në SHBA. Gjatë bisedës Meta u shpreh mirënjohjen për kontributin e tyre.

shumë sesa në 20 e kusur vite pararendëse, të marra të gjitha së bashku dhe jo vetëm sot s'është më një pasuri në rrezik për sa i përket UNESCO-

s, por ka hyrë në një fazë të re. Ky projekt i realizuar në bashkëpunim me Fondin është një kartvizitë e kësaj faze të re".

**REPUBLIKA E SHQIPËRIE**  
Zyra përbarimorë "Best 2019"

**SHPLLJE ANKANDI**

Më datë **19 tetor 2018** nga ora **08.00-ora.16.00** tek kjo zyre përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e I-rë, për shitjen e apartamentit nr. 3/218+1-18, vol 35, fq 39, ZK.8350, sip. 103.90 m2 me çmim fillestar 81.600 lek/m2.

Apartamenti ndodhet në Tiranë (prapa Prokurorisë Rrethit Tiranë).

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

**Njoftim për shitje me ankand te dyte**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e dorëzansin K.S të ndodhura në Panahore Mallakaster. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga:

Pasuria "Ara" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me sipërfaqe 2500 m2 ZK 2869 Mallakaster me çmim 840.000 leke. Pasuria "Ara" nr.206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869 Mirallakaster, me çmim 56.000 lek/Pasuria me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në ZK 2869 dhe ndodhet në Mallakaster me çmim në masën 280.465 leke.

Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet ditë 18.10.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishar" Kulla 1,Kati 2, zyra.5. Kont.tel. 672082543, e-mail:llir\_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice.al.com

**Shoqëria përbarimorë JUSTITIA**

shpall ankandin, faza e parë për shitjen e pasurisë së paluajtshme sipas Certifikatës provizore për regjistrimin karabinë: Pasuri e paluajtshme, Apartament me sipërfaqe 70m<sup>2</sup>, e regjistruar në regjistrin hipotekor me Nr.117, datë 29.04.2009, me Nr. Pasurie 6/2+1-1, në Zonën Kadastrale 3126, me Adresë: Shëngjin, Lezhë, regjistruar në emër të Shaban Elezi dhe Taze Smajal, hipotekuar në favor të BKT BANK.

Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 2.400.000 (dy milion e katërqind mijë) lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 16.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2278090/ 0693177499



Kreu i PDIU-së, presidentit grek: U vranë 2771 çamë dhe nuk treguat dokument

# "Çamët ndihmuan nazi-fashistët", Idrizi: Rama e Bushati të flasin

"Deklarata kërcënuese për integrimin e Shqipërisë"

**K**reu i Partisë Drejtë si Integrim dhe Unitet, Shpëtim Idrizi kërkoi një qëndrim të kryeministrit Edi Rama dhe ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati, lidhur me deklaratat e bëra nga presidenti grek Pavlopulos se çamët ndihmuan nazistët. Në një deklaratë të tij, Idrizi u shpreh se në vitet 1944-1945, janë vranë barabisht 2771 civilë nga Çamëria dhe se Greqia kurrë nuk tregoi një dokument apo një foto që vërteton se shqiptarët e Çamërisë kanë pasur lidhje me nazi-fashistët. Kreu i PDIU shprehet se deklaratat janë të papranueshme. "Shqipëria nuk ka një sovranitet të kufizuar nga Republika e Greqisë dhe e ardhmja e saj në strukturat Europiane dhe Euroatlantike nuk varen nga Greqia dhe prandaj deklarata më e fundit, e një cikli deklaratash e presidentit grek Pavlopulos, është një monolog krejt i vjetruar dhe pa vend", tha dje Idrizi. "Zoti Pavlopulos ju thoni se "Çështja çame është një çështje nderi" për ju, dhe këtu kemi të drejtë, ashtu si edhe për ne, Çështja çame është një çështje nderi dhe drejtësie, sepse jeni treguar krejt hipokritë dhe të pandershëm me popullin grek dhe me popullin shqiptar, në trajtimin e shtrëmbëruar historik të kësaj çështjeje. Në gjyqin farsë të Janinës, ju nuk provuat dot kurrë se kishte kriminelët luftime nga radhët e popullsisë çame dhe me të drejtë nuk kërkuat kurrë se ku janë "fshehur" këta kriminelë që nuk kanë ekzistuar kurrë, por ishin vetëm një shpikje qëllimkeqe e djallëzore me paramendim", -u shpreh kreu i PDIU-së, drejtuari presidentit grek. "Ndërkohë kemi harruar me qëllim, simpatitë pronaziste dhe ideologjinë fashiste të diktatorit fashist Metaxa, që përshëndeti pushtimin fashist të Shqipërisë nga Italia në vitin 1939. Harroni qëllimisht zotin Joanis Relis, kryeministrin Kuising, pro fashist dhe nazist, dënuar nga gjykatat greke si kolaboracionist, porse kjo nuk e pengoi të birin e tij që në vitin 1980, të vinte në krye të Greqisë si kryeministër", tha më tej, Idrizi. "Harroni zoti Pavlopulos që u dogjën



**DEKLARATA**  
"Sot shqiptarët duhet të mësojnë që vendi më të cilin qeveria shqiptare kërkon të firmose Marrëveshjen e Partneritetit Strategjik, nuk njeht gjenocidin mbi shqiptarët e Çamërisë nuk njeht shtetin e Kosovës dhe që mban ende në fuqi ligjin e luftës me Shqipërinë", -tha dje, Idrizi.

## Presidenti grek: E mbështesim Shqipërinë për në BE, por të harrojë çështjen çame

**P**residenti grek, Prokopis Pavlopulos, gjatë një vizite të tij në Paramithia, një qytezë çame, ka paralajmëruar shtetin shqiptar se, nëse do përkrahjen e Greqisë për t'u integruar në Bashkimin Evropian atëherë duhet të pranojë qëndrimin se çamët janë bashkëpunëtorë të nazistëve. "Duhet të jemi të ndershëm. Nëse shqiptarët e duan miqësinë tonë dhe fqinjësinë tonë të mirë, ne i mbështesim në perspektivën e tyre evropiane, e cila është e nevojshme për ta. Por duhet që menjëherë të pranojnë një të vërtetë historike lidhur me të ashtuquajturën çështje çame dhe të mos e përmendin më asnjëherë në marrëdhëniet tona. Çdo që kalon nga respektimi i të vërtetës dhe historisë. Duhet të dinë se çamët ishin bashkëpunëtorë të nazistëve. Për sa kohë që Shqipëria i mbështet, mbështet bashkëpunëtorët e nazistëve, pra mbështet ata që përgjakën Europën. Europa, në të cilën ata duan të hyjnë, është një ndërtesa ku bota nuk do të shohë të përsëriten më këto krime. Nuk është çështje hakmarrjeje, por çështje drejtësie", -tha Pavlopulos.

dhe u plaçkitën 5800 shtëpi dhe 68 fshatra, në ato kohë të tmerrshme masakrash që nuk mund të përshkruhen. Nuk ka asnjë të dhënë që Çamët, vranë, dogjën dhe masakruan veten e tyre, por ishin viktima të një gjenocidit të mirëfilltë dhe mirëorganizuar. Ata që kanë bërë këto masakra si Napoleon Zerva, i keni ndëruar me monumente dhe mirë keni bërë, se këtu kemi përjetësuar krimin dhe turpin e tyre dhe tuajin.

Mbas kaq vitesh, vini e na thoni se çështja çame është për ju një çështje nderi dhe drejtësie dhe unë

ju ftoj, ta vendosni në vend nderin dhe drejtësinë, me kokë lart dhe jo të përmbysur, ashtu si edhe vijoni ta bëni edhe sot", -iu drejtua Idrizi Pavlopulos-it. Duke e cilësuar guxim antihistorik, Idrizi iu drejtua presidentit grek se po ndërhyr në punët e brendshme të Republikës së Pavarur të Shqipërisë.

"Po pres reagimin zyrtar të kryeministrit shqiptar dhe të ministrit të Jashtëm Bushati, të cilët bëjnë sikur nuk shohin e nuk degjojnë, këto deklarata të papranueshme, antihistorike dhe kërcënuese për integrimin evropian të Shqipërisë", -theksoi Idrizi.

## PËRGJIGJJA

**Panariti: Greqia bëri masakër në Panarit, vrau 374 vetë**

**I**sh-ministri i Bujqësisë, Edmond Panariti, me anë të një statusi në "Facebook" ka reaguar ndaj deklaratës së presidentit grek Prokopis Pavlopulos se çamët kishin sjelljen e sundesit dhe bashkëpunonin me nazistët. Në statusin e tij, Panariti shkroi dje, se presidenti nuk mund të akuzojë si bashkëpunëtorë të nazizmit një popullsi të tërë, pasi bashkëpunëtorë ka pasur në të dyja krahët edhe nga ajo greke. Më tej, deputeti i LSI-së, ka kujtuar masakrën në fshatin Panarit më 1914 ku edhe u vranë 374 burra, gra dhe fëmijë. Askush atje, nuk bën përgjegjës popullin grek për këtë. "Nuk mund të akuzosh si bashkëpunëtorë të nazizmit një popullsi të tërë z. Pavlopulos! Sepse të tillë nuk mund të jenë ata mijëra pleq, plaka, nuse të reja çame me foshnje në krahë, të zbuar dhe përndjekur padrejtësisht nga shtëpitë dhe trojet e tyre", u shpreh Panariti.

## 1 mijë efektive ushtarake certifikohen nga NATO

### "Të gatshëm për luftë", Xhaçka: Sot jemi të barabartë mes të barabartëve

**F**orcat e Armatosura të Shqipërisë kanë tashmë pjesë të tyre një grup batalion me aftësi të plota luftarake, vlerësuar kjo sipas standardeve të NATO-s. Në fund të stërvitjes një javore "Albania Lion/Biza 18", ku morën pjesë mbi 1 mijë e 200 trupa e mjete ushtarake, Grup-Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë u certifikua si "Combat Ready" (i gatshëm për luftë), nën monitorimin e ekspertëve të NATO. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka në fjalën e saj në përfundim të stërvitjes tha se Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë shënuar një pikë kthese në historinë e tyre, duke u renditur të barabartë mes të barabartëve. "Certifikimi, nga ana e NATO-s, Grup i Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë dhe deklarimi i tij, (Combat Ready), "I gatshëm për luftë" shënon përmbyshjen e pjesës më të rëndësishme të detyrave tona të shtëpisë, detyrimeve të Paketës së Objektivave të Kapaciteteve të vendit tonë ndaj Aleancës. Ndaj pa frikë mund ta quajmë këtë hop cilësor, një eventim historik në marrëdhëniet tona me NATO-n", - theksoi më tej ministria Xhaçka. Ndërsa ka përgëzuar Forcat e Armatosura për arritje, ministria e Mbrojtjes nënvizoi se, progresi është i preksdhëm dhe ambicia do të jetë modernizimi i plotë strukturave të FA. "Forcat e Armatosura i dalin zot çdo pune dhe detyrë që ju ngarkohet. Ashtu siç dinë të kryejnë operacione luftarake dhe paqeruajtëse, ashtu dinë edhe të kryejnë shërbime atje ku të tjerët e kanë të pamundur. Të tillë jeni ju, të gatshëm në çdo kohë në shërbim të qytetarëve dhe të vendit", - iu drejtua ministria efektiveve të pranishëm në aktivitetin masiv në Bizë.



Marrëveshja me Greqinë, Zaev: Vendimi do t'i kalojë Kuvendit

# Emri i Maqedonisë, dështon referendumin

## Kreu i Kuvendit s'ishte në listë, 34.76% qytetarë votuan

Ditën e djeshme u realizua referendumi për emrin e Maqedonisë. Ajo që bëri përshtypje ishte pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në votimin e sotëm. Ndërkohë që një grup i caktuar qytetarësh, një orë pas përfundimit të referendimit u mblodhën përpara Kuvendit duke festuar bojkotin e bërë për mospjesëmarrjen në referendumin e djeshëm. Mbi 1.8 milionë qytetarë do shprehin vullnetin e tyre në aprovim ose në kundërshtim të ndryshimit të emrit. Siç e përcakton edhe rregullorja, qendrat e votimit janë hapur në orën 7:00 dhe votimi u mbyll në orën 19:00. Ky referendum do të ketë një pyetje: A jeni për anëtarësim në NATO dhe BE me pranimin e marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë? Rreth 12 mijë vëzhgues vendas dhe 320 vëzhgues të huaj janë akredituar për ta ndjekur procesin. Ndërkohë, ditën e shtunë shfrytëzuan të drejtën e votës personat e sëmurë, të burgosurit si dhe shtetasit që jetojnë jashtë Maqedonisë. Siç raportojnë mediat maqedonase, 4963 persona të sëmurë patën të shtunën të drejtën e votës, ndërsa 1558 ishte numri i të burgosurve. Mësohet se jo më shumë se 35% nga lista e të paraqiturve për të votuar në diasporë kanë dalë dhe kanë votuar dje nëpër gjithë kryeqytet e botës. Ndërkohë nëpër burgjet e Maqedonisë ka pasur pjesëmarrje relativisht të madhe, apo 64.69% nga 1558 persona të regjistruar për të votuar. Personat e sëmurë kanë votuar në shumicë, pra 1520 vota nga 1859 të regjistruar. Gjithëse, dje në Maqedoni u votua në 3478 vendvotime, si pjesë e 80 komunave. Parlamenti e ka miratuar tashmë emrin Republika e Maqedonisë së Veriut, por kundërshtimi nga ana e presidentit George Ivanov, e çoi çështjen drejt verdiktit të popullit. Kujtojmë që referendumi të jetë i suksesshëm, duhet që të paktën 853 mijë qytetarë të votojnë pro tij. Ndërkaq, vetëm katër orë nga hapja e qendrave të votimit, pjesëmarrja në votime për referendumin për çështjen e emrit në Maqedoni, u paraqiti e ulët. Sipas të dhënave të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, në votime morën pjesë 3% e votuesve. Në konferencën e parë për shtyp, KSHZ njoftoi se kishte pasur tre kundërshtime për shkeljen e votimit, raste që janë refuzuar. Kujtojmë se mbi 1.8 milionë qytetarë shprehën vullnetin e tyre në aprovim ose në kundërshtim të

### ZORAN ZAEV:

"Nëse nuk arrihet numri i konsiderueshëm i votave nga qytetarët vendi do të shkojë në zgjedhje të parakohshme në Kuvend për të marrë vendimin final", ka thënë kreu i qeverisë së Maqedonisë.



### GREQIA: MAQEDONASIT PRO MARRËVESHJES

"Respektojmë zgjedhjen e qytetarëve maqedonas dhe mbetemi të përkushtuar për marrëveshjen e Prespës. Pjesa më e madhe mbështetën marrëveshjen. Klima e nacionalizmit nuk lejon të bëhet një vlerësim i kthjellët për dobinë e marrëveshjes"- thuhet në reagimin e Ministrisë greke.

emrin, bëri thirrje të hapur të premtën nga foltorja e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara ku mbajti një fjalim, për bojkotin e referendimit. Sipas tij, Greqia do të ketë një pozitë superiore dhe mbikëqyrëse ndaj ndryshimeve që mund të bëhen në Republikën e Maqedonisë si rezultat i Marrëveshjes së Prespës. Drejtues e zyrtarë të lartë perëndimorë vizituan javët e fundit Shkupin për të bindur kundërshtarët e referendimit se ndryshimi i emrit të Maqedonisë ishte kushti i vetëm për integrimin e vendit në NATO dhe BE. Që referendumi të cilësohet i suksesshëm mbi 50% e votuesve duhet të votojnë pro pyetjes: "A jeni për anëtarësimin e vendit në NATO dhe BE duke pranuar marrëveshjen midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?"

### REAGIMET

Në mbyllje të votimit, do të një konferencë për media edhe kreu i qeverisë, Zoran Zaev. Në fjalën e tij, Zaev nuk foli as për censurën e as për pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve, por tha se qytetarët folën ditën e sotme me votën e tyre. Gjithashtu ai tha se nëse nuk arrihet numri i konsiderueshëm i votave nga qytetarët vendi do të shkojë në zgjedhje të parakohshme në Kuvend për të marrë vendimin final. Ndërkaq në konferencë do të ndodhte edhe opozita, kreu i BDI-së. "Dita e sotme është një nga ditët më të rëndësishme të Maqedonisë. Qytetarët ia deleguan vendimarrjen Kuvendit. Me votën tonë ne përcaktojmë të ardhmen e vendit tonë si dhe të së ardhmes së Europës Juglindore. Ai, gjithashtu, shtoi se dita e djeshme ishte një ditë festive, sepse njerëzit treguan se me paqe e qytetari mund të marrin një vendim të heshtur lidhur me të ardhmen e Maqedonisë. Sovrani vendosi me votën e tij dhe ne do të ndjekim vendimin e sovranit",-ka thënë Xhaferri.

## Meta thirrje shqiptarëve në Maqedoni: Pro në referendum

Presidenti Ilir Meta ka përhëndetur votimet për referendumin për emrin e ri të Maqedonisë. Përmes një statusi në 'Facebook' Meta theksoi se shqiptarët e Maqedonisë kanë mundësinë që të tregojnë përkatësinë e tyre euro-atlantike jo vetëm duke votuar qartësisht PRO."Qytetarët e Maqedonisë janë thirrur të vendosin për të ardhmen e tyre. Pjesëmarrja sa më e madhe e tyre në referendum është vendimi i duhur, i mençur dhe i përgjegjshëm në këtë ditë historike për ta. Shqiptarët e Maqedonisë kanë sot sërish mundësinë të tregojnë përkatësinë e tyre euro-atlantike jo vetëm duke votuar qartësisht PRO, por sidomos duke marrë pjesë masivisht në këtë votim historik për të ardhmen e Maqedonisë", shkruan Meta në 'Facebook'.



## Referendumi, Rama: Kush s'voton, rrezikon të ardhmen

Kryeministri Edi Rama iu është bashkuar reagi Kneve për referendumin që u mbajt të dielën në Maqedoni për emrin. Përmes një mesazhi në Twitter Rama iu bëri thirrje qytetarëve shqiptarë që të votojnë pro referendimit. Po ashtu kreu i qeverisë shqiptare shkruan se mospjesëmarrja në votime rrezikon të ardhmen e vendit. "Uroj shumë që çdo shqiptar i Maqedonisë ta kuptojë peshën e përgjegjësisë që ka sot, pavarësisht çdo bindjeje politike a përkatësie partiake. Sot në Maqedoni votohet për fëmijët dhe kush nuk voton rrezikon të ardhmen e tyre!",-shkruan Rama.



### ALI AHMETI:

Dita e sotme është një nga ditët më të rëndësishme të Maqedonisë. Qytetarët ia deleguan vendimarrjen Kuvendit. Me votën tonë ne përcaktojmë të ardhmen e vendit tonë si dhe të të ardhmes së Europës Juglindore.

### TALAT XHAFFERRI:

"Dita e sotme është një ditë festive, sepse njerëzit treguan se me paqe e qytetari mund të marrin një vendim të heshtur lidhur me të ardhmen e Maqedonisë. Sovrani vendosi me votën e tij dhe ne do të ndjekim vendimin e sovranit",-ka thënë Xhaferri.

ndryshimit të emrit, ndërsa me votë do t'i përgjigjen edhe pyetjes; A jeni për anëtarësim në NATO dhe BE me pranimin e marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë?

### FUSHATA

Gjatë fushatës partitë e pushtetit kanë mbajtur takime me qytetarë, por jo mbingje të mëdha dhe janë angazhuar në një fushatë mediatike ku kanë shpalosur përparësitë e marrëveshjes me Greqinë për

çështjen e emrit, për çfarë duhet të vendosin votuesit në referendum. Edhe partitë shqiptare, të cilat nuk janë pjesë e qeverisë, si Aleanca për Shqiptarët, e njëri krah i Lëvizjes "Besa" janë hedhur në fushatë duke u bërë thirrje shqiptarëve që të dalin në referendum dhe të votojnë pro pyetjes së shtuar aty, për ndryshimin e emrit nga Maqedoni në Maqedoni të Veriut. Megjithatë opozita shqiptare kërkoi që pas ref-

erendimit kur të fillojë procesi i ndryshimeve kushtetuese, shqiptarët e Maqedonisë të figurojnë si element kushtetues në preambulë e jo siç është aktualisht: "pjesëtarë të një komuniteti që përbën të paktën 20 për qind të popullatës së vendit". Nga ana tjetër, kundërshtarët e referendimit kanë bërë thirrje për bojkotin, pasi sipas tyre preken interesat kombëtare dhe vetë identiteti dhe gjuha maqedonase.

Partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE, ndonëse nuk ka bërë thirrje direkte zyrtare për bojkotin e referendimit, siç duket për shkak të mosmarrëveshjeve brenda strukturave drejtuese, ua ka bërë me dije qoftë përmes medias apo rrjeteve sociale përkrahësve të saj se nuk duhet dalin në referendum. Ndërkohë, presidenti George Ivanov, i cili e ka kundërshtuar marrëveshjen me Greqinë për



**Aksion në Lezhë, 4 në pranga, 15 të shoqëruar**

**Mina me telekomandë dhe kanabis në bagazhin e "Opel"-it, arrestohet Endrit Vejsiu**

Drejtori i Policisë Vendore Lezhë, Ferdinand Mara ka dhënë detaje ditën e djeshme për operacionin e zhvilluar, ku janë arrestuar 4 persona dhe shoqëruar 15 të tjerë për vepra të ndryshme penale. Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, në vijim të punës për parandalimin dhe goditje e veprimtarisë kriminale, gjatë orëve të natës, kanë finalizuar operacionin e koduar "Telekomanda". Si rezultat, u bë i mundur kapja e shtetasit Endrit Vejsiu, 29 vjeç, nga Tirana, pasi në aksin rrugor Milot-Lezhë, në kryqëzimin e Shënkol-

**ARRESTIMI**

Policia vuri në pranga Endrit Vejsiun pasi në aksin rrugor Milot-Lezhë, në mjetin e tij tip 'Opel' në një gomë rezervë në bagazh, u gjetën të fshehura 4 mina me telekomandë. Ato ishin të paketuara me nga dy cilindra materiali të ngurtë të mbështjellë me natriban, të dyshuara lëndë plasëse e llojit TNT.

lit, në mjetin e tij tip 'Opel' në një gomë rezervë në bagazh, u gjetën të fshehura 4 mina me telekomandë. Ato ishin të paketuara me nga dy cilindra materiali të ngurtë të mbështjellë me natriban,

të dyshuara lëndë plasëse e llojit TNT. Gjithashtu, u gjetën edhe rreth 3 kilogramë lëndë e dyshuar narkotike kanabis sativa, e paketuara gati për shitje. Arrestimi i Vejsiut u bë për ve-

prat penale "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" dhe "Trafikim i lëndëve plasëse". Në vijim të kontroleve nga policia në Kurbin u kap dhe u ndalua shtetasi në kërkim Gentjan Gazmir Elezi, 32 vjeç. Gjykata e Shkallës së Parë Kurbin me vendimin e datës 24 nëntor 2015, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprat penale "Vrasje në rrethana cilësuese, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim" dhe "Mbatja pa leje e armëve luftarake dhe municionit". Po në Kurbin, u



arrestua në flagrancë shtetasi Leonard Gentjan Tafa, 35 vjeç, banues në Malbardhë. Në Laç, gjatë kontrollit, atij iu gjet e bllokua me cilësinë e provës materiale një pistoletë tip TT, me një krehër me 8 fishekë. I arrestuar në flagrancë gjatë këtyre kontroleve është edhe shtetasi Eris Gjoni, 20 vjeç, banues në Lezhë. Gjatë kontrollit tek një lokal në Lezhë, iu gjet e

bllokua në cilësinë e provës materiale një shkop hekuri policor. Gjatë 12 orëve të fundit strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë në bashkëpunim me Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë Shkodër kanë shoqëruar për verifikim 15 shtetas me precedentë penalë kryesisht të dyshuar për "Vjedhje" dhe "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike".

FRPD Sarandë akuza qeverisë: Të rinjtë po përdoren nga trafikantët për shkak të varfërisë

**Tentuan të kalonin kufirin grek me 125 kg drogë, arrestohen 7 shqiptarë**

*Sekuestrohen 6 çanta me 111 pako me marijuanë*

Në kuadër të një operacioni antidrogë policia helene ka zbuluar dhe sekuestruar në kufirin greko-shqiptar 125 kilogram marijuanë. Gjatë mbrëmjes së të shtunës forcat e policisë greke kanë pikasur 7 persona, të cilët po kalonin në këmbë kufirin. Një nga trafikantët kujdesej për kontrollin e rrugës ndërsa 6 të tjerët lëviznin së bashku, teksa transportonin çantat me lëndë narkotike. Policia e shtetit helan konfirmoj arrestimin e 7 shqiptarëve, njëri prej të cilëve rezultoi i shpallur në kërkim nën akuzën e vjedhjes në zonën e Lamias. Gjatë ndërhyrjes, policia zbuloi se në 6 çantat ndodheshin 111 pako me 124 kg 790 gram marijuanë. Krahas lëndës narkotike të rinjtë të arrestuar, të cilët varionin nga mosha 21 deri në 27 vjeç u janë sekuestruar dhe celularët, të cilët pritet të ndihmojnë për të zbuluar destinacionin e drogës shqiptare, e cila po trafikohet drejt Greqisë. Bëhet me dije se ndërsa thuhet se të arrestuarit janë të moshave nga 21 deri në 26 vjeç. Konkretisht Ilia Myrtaj, 22-vjeç, lindur në Fier; Xhuljano Haruni, 24-vjeç, lindur në Sarandë; Klaudio Pepa, 24-



vjeç, lindur në Lushnjë; Albano Hadaj, 23-vjeç, lindur në Permet; Anton Daka, 22-vjeç, lindur në Shkodër; Klaudio Dervishanji, 21-vjeç, lindur në Gjirokastrë; Gramoz Muhol-

lari, 26-vjeç, lindur në Përmet. Po ashtu raportohet se një 22-vjeçar rezultoi i kërkuar në Greqi, i dënuar në Lamia me 6 muaj burg për vjedhje dhe ndalohet hyrja për në shtetin helan. Sakaq, policia sekuestrroi edhe 4 celularë. Shqiptarët vijojnë trafikimin e lëndëve narkotike drejt Greqisë. Prej fillimit të vitit e deri sot, në Igumenicë, Korfuz, Lefkadha, Kefalonia, Janinë, Athinë, Selanik, Artë, Aitiloakarnania, Kostur, Grevena, Follorinë, Aleksandroupoli, etj. policia greke ka sekuestruar rreth 8.6 ton marijuanë që vinte nga Shqipëria.

**Forumi Rinor i Partisë Demokratike**

Pas arrestimit të 7 shqiptarëve nga policia greke në Igumenicë ka reaguar Forumi Rinor i Partisë Demokratike në Sarandë. Përmes një deklarate FRPD Sarandë thotë se të rinjtë po përdoren nga trafikantët për shkak të varfërisë

në të cilën ndodhen. "Ngjarja e mbrëmjes se datës 29.09.2018, ndodhur në Drimitsa, Igumenice, ku 7 të rinj shqiptarë të moshës 21-26 vjeç, u kapen nga policia greke duke kaluar kufirin në këmbë e te ngarkuar me çanta që përmbanin 125 kg marijuanë, tregon edhe njëherë situatën tepër të rëndësishme ku ndodhen sot të rinjtë shqiptarë. Fakti që të rinjtë e kapur mbrëmë, janë me origjinë nga Saranda, Gjirokastra, Përmeti, Fieri, Lushnja e Shkodra, tregon se gjeografia e papunësisë dhe shtyrja e të rinjve drejt kriminit, ka kapur kufijtë e gjithë Shqipërisë. Burime konfidenciale bëjnë të ditur se të rinjtë që transportojnë drogë maleve, përdoren nga grupe kriminale kundrejt shpërblimeve qesharake dhe se numri i të burgosurve muajt e fundit në të dyja anët e kufirit për këtë vepër penale, është me dhjetëra. Ngjarja e mbrëmshme, tregon fytyrën e vërtetë të Rilindjes, fytyrën e vërtetë të aktualitetit shqiptar, fytyrën e vërtetë të situatës në të cilën ndodhet rinia sot. Forumi Rinor i Partisë Demokratike dega Sarandë, dënon me force fenomenin e trafikimit të lëndëve narkotike, por mbi të gjitha dënon aktin e paprecedent të shtyrjes së të rinjve drejt veprimtarisë kriminale, ardhur si pasojë e gjendjes mjaft të rëndësishme dhe ekonomike që po përjeton brezi i ri në ditët e sotme", thuhet në reagimin e Forumit Rinor të Partisë Demokratike në Sarandë.

**NGJARJA**



**Drejtonte makinën i dehur, arrestohet zyrtari i policisë**

**FIER**- Arrestohet shefi i stacionit të policisë së Patosit Flamur Veliu. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ndaloi mbrëmjen e së shtunës Flamur Veliu pasi u kap duke drejtuar makinën në gjendje të dehur. Sipas të dhënave, Veliu përplasi disa mjete të parkuara në hyrje të qytetit të Fierit. Policia ka kryer veprimet hetimore dhe procedurale dhe ka referuar materialet në prokurori për rastin në fjalë. "Nga oficerët e Policisë Gjyqësore në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Flamur Veliu, 60 vjeç, banues në Lushnjë, me detyrë Shef i Stacionit të Policisë Patos. Arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi në aksin rrugor Fier - Lushnjë në vendin e quajtur "Mulliri i artë" Fier, është përfshirë në një aksident automobilistik me dëme materiale dhe pas verifikimit me aparat alkoltest ka rezultuar se drejtonte mjetin "Fiat Stilo" në gjendje të dehur. Materialet hetimore lidhur me këtë ngjarje ndaj shtetasit Flamur Veliu, do t'i referohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprën penale "Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt", thuhet në njoftimin e policisë.

**ZJARR NË MASHKULLORË, DIGJEN 250 RRËNJË LAJTHI**

**GJIROKASTER**-Një vatër zjarri është regjistruar ditën e djeshme në fushën e Mashkullorës. Mësohet se flakët rrezikojnë disa hektarë me vreshta. Kjo është vatra e dytë e zjarrit ditën e sotme, pasi më herët u regjistrua një zjarr në fushën e Lazaratit. Dyshohet se zjarret kanë qenë të qëllimshme për djegjen e kullotave, ndërsa era ka favorizuar përhapjen e tyre. Deri më tani raportohet për 250 rrënjë lajthi të djegur, që ishin në fazën fillestare të rritjes. Pas ndërhyrjes së zjarrfikësës, u bë e mundur shuarja e flakëve.

**FOTOLAJMI**

Së shpejti libri më i ri, “Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist”, i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi


Informacioni i vitit 1973 për Komitetin Qendror me diskutimet e denoncimet në Teatrin Popullor, nga aktorët e njohur: Pirro Mani, Naim Frashëri, Kadri Roshi, Sulejman Pitarka, Lazër Filipi, Esma Agolli etj.

# Raporti: “Piktori i Teatrit, Oseku, i vetmi burrë që del me maksipalito si Napolon Bonaparti”

“Pirro Mani nuk ia jepte Lazër Filipit rolin e Viktor Gjokës se nuk kishte besim”

Në janarin e vitit 1973, vetëm pak ditë pas Festivalit të 11-të Kom-bëtar të Këngës në Radio-Televizion, në të gjitha institucionet kulturore dhe artistike të kryeqytetit dhe në mbarë vendin, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, filluan mbledhjet dhe analizat. Ashtu siç do të shohim edhe në mjaft kapituj pasardhës të këtij libri, një nga institucionet kulturore artistike ku u zhvilluan më shumë mbledhje dhe analiza pas fjalës së Enver Hoxhës mbajtur në aparatun e Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Plenumin e III-të të Komitetit Qendror të PPSH-së në fillimin e vitit 1973, ishte Teatri Popullor. Gjë e cila nënkuptonte rëndësinë e madhe që i jepte udhëheqja e lartë e PPSH-së dhe propaganda zyrtare atij institucionit që po ashtu ishte dhe nga më të frekuentuarit edhe nga “masat punonjëse”, duke gjallëruar jetën kulturore e artistike në kryeqytet dhe mbarë vendin. Në këtë kontekst edhe vëmendja e udhëheqjes së lartë ishte përqendruar aty edhe për vetë impaktin dhe popullaritetin që kishin dhe gëzonin aktorët e skenës dhe ekranit në mbarë vendin, madje edhe më shumë se një pjesë e udhëheqjes së lartë, për vetë kontaktet e shpeshta që ata kishin me publikun nga skena e teatrit apo dhe ekranit i kinemasë e televizionit. Nga sa më sipër kjo gjë bëhet e ditur edhe nga fakti që në mbledhjet e organizatës bazë të partisë së Teatrit Popullor, udhëheqja e lartë e PPSH-së ka dërguar si të deleguar dy nga personazhet kryesorë që mbulonin artin e kulturën (si në rrugë partie ashtu dhe

në rrugë shtetërore), siç ishin ministri i Arsimit Kulturës, Thoma Deljana dhe Fadil Paçrami, sekretari i Komitetit të Partisë së Tiranës, dramaturg i njohur që mbulonte artin e kulturën dhe një nga anëtarët më me popullaritet të Komitetit Qendror të PPSH-së. Po kështu përveç dy funksionarëve të lartë, në mbledhjen e organizatës bazë të Teatrit Popullor, e cila u zhvillua në ditë e para të marsit 1973, ka asistuar dhe Todi Kokoneshi (instruktur në K.Q. të PPSH-së për artin dhe kulturën), i cili ka hartuar dhe informacionin për eprorët e tij në Komitetin Qendror. Por ndryshe nga pjesa më e madhe e të gjitha dokumenteve të kësaj natyre të publikuara në këtë libër dhe jo vetëm, ky informacion nuk është parë dhe siguar as nga Enver Hoxha, dhe as nga Ramiz Alia e ndonjë nga sekretarët e tjerë të Komitetit Qendror, siç dhe funksiononte praktika normale mes tyre. Por raport-informacioni është deleguar për të Hamit Begja, gjë e cila duket se ka ndodhur për shkak të ngarkesës së madhe të punës që kanë pasur Enver Hoxha me Ramiz Alinë, pasi “kishte plasur” çështja e Festivalit të 11 të këngës në Radio-Televizion. Ashtu siç do të shohim edhe në dokumentin në fjalë, (gjihtnjë sipas instruktorit, Kokoneshi), gjendja në Teatrin Popullor, si gjatë vitit 1972 dhe në vijim, deri në atë ditë, që është mbajtur ajo mbledhje, paraqitej mjaft e zymtë, madje tejet alarmante. Gjë e cila kishte bërë që, nga katër premiera që kishte plani për atë vit të realizohej vetëm një dhe nga 51



Ali Oseku

aktorë që kishte teatri, më shumë se gjysma rrinin pa punë dhe nuk aktivizoheshin fare. Kjo gjë si për shkak të shtyrjes që mbizotëronte aty ashtu dhe për faj të frymës liberale që mbizotëronte si tek drejtuesit ashtu dhe kolektivit të atij institucioni. Nisur nga të gjitha këto, instruktori Kokoneshi ka pasqyruar në raport-informacionin e tij edhe diskutimet e disa prej aktorëve më të njohur, si: Pirro Mani, Naim Frashëri, Kadri Roshi, Sulejman Pitarka, Lazër Filipi, Esma Agolli etj., të cilët nxirrin në pah kontradiktat midis tyre. Po kështu në atë mbledhje duket që

nuk kanë munguar as denoncimet, si p.sh. për piktorin Ali Oseku, pasi në raport thuhet se: “Ai është i pari në Tiranë ndër burrat që qep një maksipalito e ngjashme me atë të Napolon Bonapartit. Ky piktor ka gjetur përkrahe nga Bardhyl Kosova dhe Mihallaq Luarasi”. Kritika, akuzat dhe denoncimet do të kishte dhe për Fadil Paçramin e drejtorin e Teatrit Bardhyl Kosova, të cilat duket se po ngrinin siparin dhe po parapërgatitnin një furtunë të madhe ndaj tyre në ditët dhe muajt në vijim, gjë e cila si rezultat sollë edhe denimin e tyre në burgjet e regjimit komunist të Enver

Hoxhës. Ashtu si dhe pjesa më e madhe e dokumenteve të publikuara në këtë libër, edhe ky jepet i plotë dhe pa asnjë shkurtim.

## INFORMACION

### MBI MBLEDHJEN E ORGANIZATËS BAZË PER DHENIE LLOGARI DHE ZGJEDHJE NE TEATRIN POPULLOR

Asistova në mbledhjen e organizatës bazë për dhënie llogari dhe zgjedhje në Teatrin Popullor, si dhe mbledhjet e kolektivit të këtij teatri, kur u punua fjala e shokut Enver në Presidiumin e Kuvendit Popullor dhe në Plenumin e III-të të Komitetit Qendror. Në mbledhjen e organizatës asistonte si i deleguar shoku Thoma Deljana. Mori pjesë dhe shoku Fadil Paçrami.

Raporti që u dha në mbledhjen e organizatës bazë ishte i përhapur në shumë çështje, pa analizë dhe i mungonte fryma e kritikës dhe autokritikës. Por ajo që nuk u bë nga raporti u plotësua mirë nga diskutimet e gjalla që u bënë nga pjesa dërmuese e komunistëve. Ata e analizuan punën e tyre dhe të organizatës me një ndjenjë të lartë përgjegjësie, kritikuan për ndrojtje dhe dobësitë e mëdha që ekzistojnë në institucionin e tyre dhe disa çfaqje të huaja që janë manifestuar atje.

Nga diskutimet që u bënë në mbledhjen e organizatës bazë për dhënie llogari e zgjedhje dhe në mbledhjen e kolektivit duallën këto çështje:

1. U theksua nga të gjithë se në Teatrin Popullor



ka mungesa të theksuara në organizimin e punës, ka çthurje dhe liberalizëm. Të gjithë aktorët dhe aktoret që diskutuan theksuan me forcë se nuk ngarkohen me punë, kemi rënë, thanë ata, në një batak plotësisht, për të cilën kemi ngritur shpesh zërin por nuk po dëgjohehi.

Në Teatrin Popullor punojnë 51 aktorë, por zakonisht aktivizohen gjysma e tyre dhe gjysma tjetër rri gati pa punë. Nuk organizohet puna që të punohet paralelisht për përgatitjen e dy pjesëve dhe dhënies së tyre në të njëjtën kohë, p.sh. një pjesë mund të jepnin çfaqje në Tiranë dhe pjesa tjetër në fshat ose në rrethe të tjera të vëndit. Disa nga aktorët e vjetër që janë plakur dhe nuk japin dot më, si dhe disa të rinj të pataleutuar rrinë thuajse krejt pa punë. Për këto u çfaq mendimi unanimes se duhen marrë masa për t'i sistuarur gjatë.

Shumë pjesë të repertorit të përgatitur vite më parë, rrinë të vdekuara, nuk merret asnjë masë për t'i rinovuar dhe për t'i rishfaqur për publikun. Me gjithë se është vendosur se në të gjitha pjesët rolet kryesore të dublohen, nuk bëhet asnjë punë e organizuar në këtë drejtim. Si rrjedhim shumë pjesë ku kanë deputuar artistët që sot janë të sëmure ose larguar, janë hequr fare nga repertori. Dhe këtë mungesë organizimi mundenohet ta justifikojnë duke teozuar në rrugë të shtrembër se gjoja disa nga këto role nuk mund të dublohen, sepse nuk mund të arrihen nga aktorë të tjerë, duke ushqyer në këtë mënyrë edhe sedrën e sëmure të disa artistëve. Ndërsa jeta u ka vërtetur të kundërtën. Kur u morr masa organizative, dy rrore për një vit diskutohet se nuk mund të dublohen nga aktorë të tjerë, u përgatitën mirë brenda dy ditëve. Për këtë u theksua se duhet të ketë më shumë organizim nga vetë drejtorja,

**NJOFTIM ANKANDI**

Permbarusja Gjyqesore Ermira Mhilli me adresë Lgji, "Oemal Stala", Rr. "Don Bosko", perballë Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Shkoder njofton se me datë 01.10.2018, ora 16:00 ne ambientet e saj do te zhvillohet ankandi i dyte per shijen e pasurise se paluajshme e llojit: **Ndertesë, Kati i pare i perbere nga dy dhoma,banjo,koridor,saloni dhe ballkon** me sip. 123 m<sup>2</sup>, me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592 Lgji, "Naim Gjybegu", Rr. Sali Nivica/Shkoder ne vleren 3.995.040 leke (Tremilion e nenteqind e nentehjete e pesemije e katerdhjete leke)

Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raiffeisen-Dega Shkoder (per pjesmarren ne ankand)

Ofertuesit te drejtohen prane Zyres se Permbarusjes Gjyqesore Ermira Mhilli, ose te kontaktojne neperrjet Nr.tel: 0692219253 ose adreses se emailit, ermira.mhilli@hotmail.com

**NJOFTIM ANKANDI**

Permbarusja Gjyqesore Ermira Mhilli me adresë Lgji, "Oemal Stala", Rr. "Don Bosko", perballë Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Shkoder njofton se me datë 01.10.2018, ora 16:00 ne ambientet e saj do te zhvillohet ankandi i dyte per shijen e pasurise se paluajshme e llojit: **Ndertesë, Kati perberë nga ndarje Dyqan** me sip. 113 m<sup>2</sup>, me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592 Lgji, "Naim Gjybegu", Rr. Sali Nivica/Shkoder ne vleren 3.303.216 leke (Tremilion e tre mije e dyqind e gjashtembjedhete leke)

Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raiffeisen-Dega Shkoder (per pjesmarren ne ankand)

Ofertuesit te drejtohen prane Zyres se Permbarusjes Gjyqesore Ermira Mhilli, ose te kontaktojne neperrjet Nr.tel: 0692219253 ose adreses se emailit, ermira.mhilli@hotmail.com

Permbarusi Gjyqesor Privat Çezar Beja

Permbarusi Gjyqesor Privat Çezar Beja me adresë Lajza Nr 2, Rruga "A.Goga", Oendra "Eden" K1 3, Durres, Tel 0674053771, email cezarbeja@hotmail.com

Shpall ankandin e trete per pasurite e paluajshme te debitorit Hysni Vath Gjergji, Suzana Rrahman Gjergji, Raji Hysni Gjergji

1.Llloji i prones: "ARE", Nr Pas 94, ZK 3137, Vol 4, Fq 78, Sip 2950m2, Adresa Rade, Njësia Administrative Manez, Bashkia Durres

Cmimi ankandit te trete eshte 2.509.166 leke 2.Llloji i prones: "ARE", Nr Pas 38/33, ZK 3137, Vol 5, Fq 82, Sip 2590m2, Adresa Rade, Njësia Administrative Manez, Bashkia Durres

Cmimi ankandit te trete eshte 4.273.236 leke. Ankandi do te zhvillohet ne zyrën e permbarusjes gjyqesore private, Çezar Beja ne datën 10.10.2018 duke u mbyllur ne orën 16.00



por dhe më shumë luftë nga vetë aktorët. Komunisti Lazër Filipi vuri në dukje se kish propozuar regjizorit Pirro Mani dëshirën për të dubluar rolin e Viktor Gjokës të "Fytira e dytë", me qëllim që kjo dramë e bukur të rihynte në repertorin e Teatrit. Por Pirro Mani nuk kish pranuar duke i thënë se ay nuk mund ta realizonte atë rol. Por aktori Lazër Filipi me të drejtë nguli këmbë dhe e përgatiti vetë atë në mënyrë krejt të pavarur aq sa bindi kolektivin dhe regjizorin se mund ta interpretonte me dinjitet.



por dhe më shumë luftë nga vetë aktorët. Komunisti Lazër Filipi vuri në dukje se kish propozuar regjizorit Pirro Mani dëshirën për të dubluar rolin e Viktor Gjokës të "Fytira e dytë", me qëllim që kjo dramë e bukur të rihynte në repertorin e Teatrit. Por Pirro Mani nuk kish pranuar duke i thënë se ay nuk mund ta realizonte atë rol. Por aktori Lazër Filipi me të drejtë nguli këmbë dhe e përgatiti vetë atë në mënyrë krejt të pavarur aq sa bindi kolektivin dhe regjizorin se mund ta interpretonte me dinjitet.

Teatri Popullor është shumë keq me repertorin, atij aktualisht i kanë mbetur vetëm tre pjesë dhe këto të konsumuara. Në mbledhje doli se janë të gjitha mundësitë që brenda një koha të shkurtër, të rihyjnë disa nga pjesët më dinjitoze të repertorit të vjetër të Teatrit Popullor, si: "Familja e peshkatari", "Toka jonë", "Mbi gërmadhat", "Shtatë shaljanët", "Orët e Kremlinit" etj.

I tërë preukopimi i drejtorisë u tha në organizatë është që të korigjohet plani se goja është i madh, në një kohë që nuk merret asnjë masë organizative për të angazhuar të gjithë trupën në punë. Planin e kemi diskutuar dhe aprovuar thonë ata, aq është i realizueshëm, por mungon lufta për ta realizuar atë. Si rrjedhim i këtyre dobësive për vitin 1972 nuk u realizuan 113 çfaqje, dhe për dy muajt e parë të këtij vitin kanë një deficit prej 22 çfaqjesh. Pra dhe fillimi i këtij viti është i keq.

Si në organizatë dhe në kolektiv u kritikua rëndë fakti që për gjithë vitin 1972 u përgatit vetëm një premier, nga katër që ishte plani dhe nga pesë që ishte plani për vitin 1971. Për përgatitjen e pjesës "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", u deshën 6 muaj, po kështu dhe për dramën "Orfeu zbrat në ferr", kur kanë qenë të gjitha mundësitë që të përgatiteshin për jo më shumë se 2-3 muaj sepçila. Ky është një lloq si madh tha komunisti Tefi Pali, që nuk e ka asnjë teatër tjetër në botë. Për përgatitjen e pjesëve dhe për punën në përgjithësi u tha të caktohet norma dhe jo të mbetemi në pushtetin e regi-

janë shkaktuar qeshje. Ditë e fundit në dramën "Një dimër i shkurtër", në pjesën e saj më dominante një nga aktorët duke deformuar tekstin përdori fjalë të tilla banale të cilat çedukojnë dhe shkaktoi qeshjen nga të gjithë aktorët e tjerë. Dhe e keqja është se këto nuk bëhen problem dhe se kalohen lehtë.

2. Si në organizatë dhe në kolektiv, u theksua se duke luftuar me sukses kundër çfaqjeve të konservatorizmit, nuk është mbajtur parasysh porosia e Partisë për të luftuar të dy krahet, si kundër konservatorizmit, ashtu dhe kundër liberalizmit.

Edhe në Teatër u përpuna një opinion i tërë se nuk duhet të mbetemi prapa botës, duhet të ecim me kohën etj, dhe me këtë u justifikuan imitimet nga të tjerët. Synohej për ta denigruar Teatrin tonë, eksperiencën e tij shumë vjeçare dhe fetishizoheshin sukseset e arritura dy tre vjetë e fundit. U kritikua shoku Fadil Paçrami se e ka quajtur Teatrin Popullor, teatër "Bogdan". Komunistët Naim Frashëri dhe Esma Agolli duke zhvilluar këtë ide theksuan se edhe aktorët më të talentuar nga të rinjtë, e ndjenin veten më të ngrohtë dhe më të sigurt se sa aktorët më të talentuar nga të vjetrit. Aktorët e vjetër filluan të denigrohen thanë ata, të quhen si limona të shtrëdhur. Me marifet u hoqën të gjithë nga puna si pedagogë në Institutin e Lartë të Arteve nën pretekstin fallos se nuk i lejon drejtorja e Teatrit Popullor. Aktorët e vjetër u vunë në fakt nën karantinë theksuan disa nga diskutantët.

Epiteti që i vijej si konservator ndaj atyre që ngrihen zërin ishte si një mjet për t'ju mblytur gjëra. Por për të paraqitur dhe ne si të rinj



dhe të kohës, tha aktori Sulejman Pitarka, filluan të lëmë dhe favorite, megjithëse ishim të bindur se nuk na shkonin.

Në organizatë dhe në kolektiv u ngrit se duke luftuar me të drejtë kundër deklamacionit në interpretimin aktorek, u kalua në ekstremin tjetër në thehtësim. Tendenda ishte për ta paraqitur aktorin si të akullit, nordik, pa ndjenja, pa temperament, duke mos patur këto asgjë të përbashkët me karakterin shqiptar.

Çfaqjet e huaja janë dukur edhe në përpjekje për të patur më shumë efekte regjizoriale të cilat bëheshin si qëllim në vet vetë, në dëm të ideve të pjesës. Kështu p.sh. ka qenë përdorimi me vend dhe pa vend i pistoletaeve, përdorimi i dritave të errta e të zbeta, dreka kthehet në darkë, aktori vihet në errësirë, nuk i jepet mundësia që ai të komunikojë direkt me spektatorët jo vetëm nëpërmjet fjalës por edhe me mimikën dhe temperamentin etj.

Më të theksuara kanë qenë influencat e huaja në dekor i cili në disa pjesë si në "Ngjarjet e vitit 1961", "Një copë rrugë", "Orfeu



zbrat në ferr", etj, nuk vihet fare në funksion të pjesës, por ndërtohet si qëllim në vetvetë. Është përhapur manija e podiumomanisë dhe shkallomanisë, për të cilat bëhen shpenzime të madha dhe nuk shërbejnë për asgjë. Në dekorin e pjesës "Ngjarjet e vitit 1961", u tha në organizatë, nuk ka asnjë element shqiptar. Përkundrazi ka një dekor ekstravagant. Në skenë vihet një tavolinë që qëndron me tre këmbë, gazetaret janë veshur kauboj si karnavale etj. Shpesh herë dekorit bëhet i rëndë dhe i pa mundur për të lojtur në skenat e tjera të vendit tonë.

Në hapjen e këtij dekori ekstravagant u tha se ka ndikuar shumë një piktor i Teatrit të Operas dhe Baletit, Ai Oseku, që është përdorur disa herë nga Teatri Popullor. rreth të cilit është krijuar një aureolë si njëri shumë i talentuar. Ai është i pari në Tiranë ndër burrat që qep një maksipallo të ngjashme me atë të Napoleon Bonapartit. Ky piktor ka gjetur përkatje nga Bardhyl Kosova dhe Mihalaj Luarasi.

Në organizatë dhe në kolektiv u theksua se për këto gjëra ka patur edhe njëjaft vërejtje nga komunistët dhe aktorë pa parti, por këto nuk merreshin aspak në konsideratë se goja bëheshin nga njerëz pa kulturë. Në këtë institucion ishte kultivuar mendimi se për problemet e Teatrit mund të ndihmojnë vetëm 3-4 veta, kurse nga të tjerët nuk mund të pritjet gjë. Ata që vendosin për çdo gjë, ishin Mihalaj Luarasi, Bardhyl Kosova, Pirro Mani dhe Ali Oseku. Duke u nisur nga koncepte të tilla shpesh herë repertori, dekori etj, nuk diskutohet fare në këshillin artistik, megjithëse një rregull i tillë ka qenë vendosur me kohë.

3. Si në organizatën bazë ashtu dhe në kolektiv, u shfaqën shumë shqetësime për repertorin. Të gjithë ishin të mendimit që preçedenca t'i jepet pjesëve të dramaturgjisë kombëtare. U kritikuan tendenca e disa regjizorëve dhe aktorëve që pjesëve të huaja u kushtojnë një punë më të madhe, kurse atyre kombëtare më pak. Në këtë aspekt u kritikua dhe politika jo e drejtë e çmimeve. Të gjithë aktorët janë lauruar në pjesët e huaja dhe pothuajse asnjë në pjesët kombëtare. Kritikë u bë edhe ndaj autorëve për të shkruar me një nivel më të lartë artistik se deri tani,

ato në përgjithësi qëndrojnë nën nivelin e Teatrit.

Nga disa diskutantët çetësimi u çfaq për të mos kaluar përsëri në ekstremin tjetër e heqjes së të gjithave pjesëve të huaja. Duke diskutuar për këtë çështje, komunisti Lazër Filipi tha se orientimet e Komitetit Qëndror dhe shokut Enver janë shumë të qarta, por nuk kuptoj përse ngatërrohen në instancat e mëzot dhe të bazës. Duke zhvilluar po këtë ide, Kadri Rroshi theksoj se burokratizmi tek ne qëndron në maninë për të qenë brenda, por kjo është frenuese.

U kritikua Komiteti i Partisë së rrethit se problemet duhet t'i përballojë më mirë. Për premierën "Orfeu zbrat në ferr", këshilli artistik mbasi e diskutoi, ishte i mendimit që ajo të shfaqej për publikun. Kurse Komiteti i Partisë, (shoku Fadil), kishte thirrur drejtorin dhe i kish thënë se tani nuk është oportune që të jepet kjo çfaqje. U tha se kjo përgjigje nuk është aspak e drejtë. Në qoftë se pjesa të mëta që nuk të vjen të jepet, ahër të argumentohet në këshillin artistik me qëllim që të nxirren mësimë nga këto gabime.

Komunisti Bardhyl Kosova u kritikua mjaft si në organizatë ashtu dhe në kolektiv. Ai u kritikua si njëri i plogët, inaktiv, indiferent, shkollaresk dhe që i ka përkrahur të ashtuquajturat "novatorizma". Sidomos ai u kritikua për mungesë të mëdha në drejtimin e punës. Diskutimi i shokut Bardhyl ishte nga më të dobët dhe aspak autokritik. Mund të jem i nxituar, por m'u krijuar përshtypja se ai nuk i ka afësitë e duhura (sidomos ato organizative), për ta udhëhequr atë institucion të rëndësishëm. Mendoj se aty ka nevojë për një kuadër të përgatitur dhe me temperament.

4. Në organizatën bazë të Teatrit ka marrëdhënie jo të mira midis disa komunistëve dhe çfaqje të mungesës së unitetit. Çfaqje të tilla ka pas e nxuarrën këkën në organizatën bazë të partisë midis drejtorit Bardhyl Kosova dhe sekretarit të organizatës bazë, Naim Frashërit, po kështu dhe mes disa komunistëve të tjerë. Megjithëse këto janë diskutuar dhe është pretenduar se janë sheshuar, por në fakt ato ekzistojnë. Shpesh herë problem nuk përballohen në organizatë, por diskutohet në shumë jashtë saj.

Një masë e rëndësishme për ta përballuar këtë gjëndje do të ishte pranimi i elementëve të rinj në Parti. Elementë të tillë ka por deri tani nuk është bërë asgjë. Moshë e komunistëve është mbi 42 vjeç.

Në fund diskutoj edhe shoku Fadil. Ai i tha organizatës se kishte ardhur për të bërë autokritikë, për disa kritika që janë bërë në adresë të tij. Mund të jem subjektiv por m'u krijuar përshtypja se autokritika e shokut Fadil qe skematike dhe e cekët, nuk kishte analizë për të shpjeguar shkaqet e këtyre gabimeve.

Tiranë, më 8.III.1973  
Todi Kokoneshi

**INFO-TAG**

**Panairi i informacionit rreth Gjermanisë**

Shkollime, studime, praktika, bursa, kërkim shkencor, mësimi i gjermanishtes, etj.

Kur? E premte, 5 tetor 2018 mund të vini të informoheni në çdo kohë nga ora 10:00 deri në 17:00.

Kur? Europe House, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë.

Për informacione të mëtejshme vizitoni: [www.tetori-gjerman.com](http://www.tetori-gjerman.com)

DAAD Deutscher Akademischer Austauschdienst German Academic Exchange Service

IPS Institut für Politikwissenschaft

GOETHE-ZENTRUM

CEAD\*

giz

30 Jahre

## MASA E PENSIONEVE RISHQYRTIMI NGA ISSH

"Si mund të mermi më shumë të ardhura. Sigurimi vullnetar, çfarë përfitojnë pensionistët"

# Ja si të rrisni masën e pensionit, procedura e rishqyrtimit dhe aplikimi ISSH: Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët

Voltiza Duro

Jo pak të moshuar shfaqin pakënaqësi në lidhje me pagesën që iu takon, në momentin që merret vendimi lidhur me masën e pensionit të pleqërisë. Por ka ende disa mënyra për të rritur masën e pensionit, apo edhe për të plotësuar vitet e munguara për të përfituar pension. Të gjithë pensionistët që nuk i kanë plotësuar vitet e përcaktuara të punës me kontribute mund të aplikojnë sigurimin vullnetar në mënyrë që të marrin pension apo masë më të lartë të tij. "Gazeta Shqiptare" publikon sot kriteret që duhet të përmbushin të interesuarit për këtë lloj sigurimi; ku në skemë përfshihen shtetasit shqiptarë që jetojnë në Shqipëri si dhe shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Gjithashtu, të interesuarit mund të informohen mbi procedurën që duhet të ndjekin për të rritur masën e pensionit duke bërë paraprakisht një kërkesë në portalin qeveritar e-albania si dhe dokumentacionin e plotë që duhet të dorëzojnë të interesuarit.

### RISHQYRTIMI

Pas marrjes së vendimit të caktimit të pensionit, përfituesi ka të drejtë të aplikojë për rishqyrtim pensioni për të dorëzuar dokumentacion shtesë, për një masë më të lartë përfitimi ose për zgjatjen e afatit të përfitimit për pensionet invalid, familjar dhe suplementar të parakohshëm. "Ky shërbim ju ofron mundësinë për të plotësuar një kërkesë online për rishqyrtimin e përfitimit tuaj (sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar).", theksohet në portalin qeveritar e-albania. Për të patur akses në këtë të fundit, të interesuarit duhet të regjistrohen si qytetar në portal dhe të plotësojnë formën përkatëse për këtë kërkesë, e cila do të hapet menjëherë pas klikimit të butonit "Përdor" në krah të këtij shërbimi. Më tej në portal bëhet me dije se numri i sigurimit plotësohet paraprakisht në momentin që aplikanti hyn në portal me kredencialet e tij përkatëse. "Me informacionin e numrit tuaj të sigurimit plotësohen automatikisht edhe të dhënat e tjera nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ju duhet të plotësoni formularin sipas fushave. Numri dhe data e protokollit do plotësohet nga punonjësit tanë. Ju mund ta ruani formën si draft për të vazhduar në një moment tjetër ose mund ta dërgoni menjëherë për procesim në



serverin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.", nënvizon e-albania për të gjithë pensionistët që dëshirojnë të aplikojnë për rishqyrtim të masës së pensionit. Ndërkohë të gjithë aplikantët pasi të kenë përdorur këtë shërbim elektronik, duhet të paraqiten në zyrat e agjencive lokale për të dorëzuar dokumentacionin e kërkuar.

### DUKUMENTACIONI

Dokumentet e nevojshme për rishqyrtim janë në varësi të objektit të rishqyrtimit. Por aplikantët duhet të kenë parasysh që të dorëzojnë një kopje të kartës së identitetit ose certifikatë personale; një certifikatë familjare; vërtetim për pagat pas vitit 1993; vërtetim nga arshiva e ISSH-së, DRSSH-së për vjetërsi në punë; vërtetim për kontributet si i vetëpunësuar në bujqësi; vërtetim për kohën e kryerjes së shërbimit ushtarak; vërtetim nga shkolla, kur fëmija është 18 vjeç - 25 vjeç; vërtetim nga Tatim Taksat për pjesëtarët që ka në ngarkim; si dhe një vërtetim nga Zyra e Punës si punëkërkuar. Ndërkohë të interesuarit duhet të dorëzojnë edhe një fotokopje të kontratës me KESH-in; dëshminë e penaltetit për të përndjekurit politikë; vërtetim i kohës së vuajtjes së dënimit (të përndjekurit politikë); diplomën e shkollës së lartë; fletëdrejtimi për në KMCAp dhe fletëdalja

tyre. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore edhe personat që nuk janë pjesëmarrës në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi ose në rastet kur individi i interesuar ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 1.1.1994 deri në datën që ka lënë shtetësinë shqiptare. "Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, është përfitues, sipas rasis, i pensionit të plotë të pleqërisë; pensionit të pjesshëm të pleqërisë; pensionit të reduktuar të pleqërisë; pensionit të invaliditetit; pensionit të pjesshëm të invaliditetit", thekson ISSH.

### SIGURIMI VULLNETAR

Në skemën e sigurimit vullnetar përfshihen të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyrues; ata që për një kohë dhe shkaqe të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm; si dhe personat që janë të siguarur në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e

### RIAPLIKIMI

Pas marrjes së vendimit të caktimit të pensionit, përfituesi ka të drejtë të aplikojë për rishqyrtim pensioni për të dorëzuar dokumentacion shtesë, për një masë më të lartë përfitimi ose për zgjatjen e afatit të përfitimit për pensionet invalid, familjar dhe suplementar të parakohshëm.

### E-ALBANIA

"Ky shërbim ju ofron mundësinë për të plotësuar një kërkesë online për rishqyrtimin e përfitimit tuaj (sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar).", theksohet në portalin qeveritar e-albania.

### Hapat e procedurës

- Për të përdorur shërbimin, duhet të regjistroheshi si qytetar në portal dhe të plotësoni formën përkatëse për këtë kërkesë, e cila hapet menjëherë kur klikoni butonin "Përdor" në krah të këtij shërbimi.
- Numri tuaj i sigurimit plotësohet paraprakisht në momentin që ju hyni në portal me kredencialet tuaja.
- Me informacionin e numrit tuaj të sigurimit plotësohen automatikisht edhe të dhënat e tjera nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- Ju duhet të plotësoni formularin sipas fushave.
- Numri dhe data e protokollit do plotësohet nga punonjësit tanë.
- Ju mund ta ruani formën si draft për të vazhduar në një moment tjetër ose mund ta dërgoni menjëherë për procesim në serverin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

### DOKUMENTET QË MUND TË DORËZOHEN JANË:

- Kopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale;
- Certifikatë familjare;
- Vërtetim për pagat pas vitit 1993;
- Vërtetim nga arshiva e ISSH-së, DRSSH-së për vjetërsi në punë;
- Vërtetim për kontributet si i vetëpunësuar në bujqësi;
- Vërtetim për kohën e kryerjes së shërbimit ushtarak;
- Vërtetim nga shkolla, kur fëmija është 18 vjeç - 25 vjeç;
- Vërtetim nga Tatim Taksat për pjesëtarët që ka në ngarkim;
- Vërtetim nga Zyra e Punës si punëkërkuar;
- Fotokopje të kontratës me KESH-in;
- Dëshmi penaltetit për të përndjekurit politikë;
- Vërtetim i kohës së vuajtjes së dënimit (të përndjekurit politikë);
- Diplomën e shkollës së lartë;
- Fletëdrejtimi për në KMCAp dhe fletëdaljet nga spitali;
- Analiza mjekësore sipas diagnozës;
- Vërtetim identiteti;
- Aktverifikim;
- Vendim gjykatë;
- Deklaratë individuale për punësim (e përvitshme) mod. 09;
- Deklaratë individuale që nuk jam i punësuar (mod. 08);
- Vërtetim i pagës referuese modelar nr.02;
- Vërtetim i pagës mesatare referuese modelar nr.03;
- Vërtetim i viteve të shërbimit modelar nr.03;
- Vërtetim për derdhje të kontributit suplementar nr.08;
- Vërtetim page referuese të përfitimit shtetëror suplementar;
- Vërtetim për periudhën e shërbimit në funksion apo detyrë;
- Vërtetim për derdhje të kontributit suplementar;
- Vërtetim i pagës referuese;
- Vërtetim për periudhën e shërbimit;



## MJEKU POPULLOR



Infeksionet  
e bajameve, si t'i  
kuron me bimë  
mjekësore

## KESHILLA



Luftoni gripin e të  
ftohtin me bimën e  
shtogut

# Prof. dr. Kim Drasa:

◆  
Mjeku urolog  
dhe seksolog:  
Studimi/  
"Disfunk-  
sioni seksual  
te burrat,  
shkatërrues"



## Shkaktarët e çrregullimeve seksuale te femrat

"Sindroma (FSD) prek rreth  
47% të femrave në Shqipëri"

**Këshilla për të marrë rezultate maksimale nga palestra**

Mjeku urolog dhe seksolog: Studimi / "Disfunksioni seksual te burrat, shkatërrues"

Voltiza Duro

# Prof. dr. Kim Drasa: Shkaktarët e çrregullimeve seksuale te femrat

"Sindroma (FSD) prek rreth 47% të femrave në Shqipëri"

Kur njëri nga partnerët seksualë ka ulje dhe çrregullime të funksionit seksual, do të ndikojë patjetër negativisht edhe tek partneri/ja. Ky është konkluzioni kryesor i studimit të paraqitur në Las Vegas nga prof. dr. Kim Drasa. Ky i fundit prej kohësh paraqet studime dhe metoda mjekimi për të ruajtur lidhjen intime të familjeve të shëndosha moralisht, të cilat nuk kanë tradhti bashkëshortore. Në studimin në Massachusetts, 52% e burrave, nga moshë 40-70 vjeç, kishin pasur ED. Në studimin në komunitetin në Boston, prevalenca ishte 22% në meshkujt e moshës 30-70 vjeç. Në studimin tonë, 17.5% e pacientëve kishin ED në stadin e moderuar deri tek e mesme.

## Si paraqiten shifrat e problemeve seksuale te femrat?

Problemet komplekse të funksionimit normal të seksualitetit femëror, kanë qenë dhe janë aktualisht një temë e një interesi dhe debati shumë të madh shkencor. Jo vetëm se ka vështirësi në lidhje për të kuptuar qartë sesi funksionon seksualiteti femëror dhe si përgjigjet femra, por, gjithashtu, sepse ka një prevalencë të lartë botërore (40%-50%), pra shumë më të lartë se problemet e seksualitetit mashkullor, i cili kap shifren 20-30%, të meshkujve, në të gjithë botën. Kjo shifer e lartë në seksin femëror është veçanërisht më e lartë, në periudhën peri-menopauze dhe pas-menopauzës. Në Shqipëri, në bazë të studimit tonë, kjo sindromë (FSD) prek rreth 47% të femrave.

## Cilët janë disa prej shkaktarëve të këtij deficit seksual femëror?

Deficitet e seksualiteti femëror (FSD), mund të shkaktohen nga çrregullime organike, veçanërisht ato sëmundje, të cilat prekin nervat që marrin pjesë në funksionimin normal seksual. Shkaktari më i zakonshëm i këtyre çrregullimeve seksuale është diabeti. Shkaktar tjetër serioz janë çrregullimet persistente të Arousal Genital (zgjimi seksual). Kjo është rrallë e dukshme te gratë, të cilat nuk kanë eksitimit seksual, gjatë gjumit. Kjo ndjesi në gjumë nuk përfundon në orgazmë

dhe përcaktohen si ndjesi të bezdisshme, të padëshirueshme, shkatërruese.

## A ka një trajtim medikamentoz për këto gra që vuajnë nga çrregullime të tilla?

Leiblum dhe Nathan (2001) ishin të parët, që dhanë një përcaktim përfundimtar të kësaj patologjie të quajtur "Syndromi i çrregullimeve persistente të zgjimit seksual" (PGAD). Këta përcaktuan pesë variante grash, të cilat vuajnë nga ky sindrom. Kërkimet mbi trajtimin e këtyre çrregullimeve seksuale femërore (FSD), kanë qenë të ngadalshme, në fushën e trajtimeve farmaceutike (nuk kanë zbuluar medikamente speciale për gratë, si kanë bërë për burrat. Përmenda këta dy grupe se koha e viagrës dhe levitres ka përfunduar. FSD (çrregullimet seksuale femërore), me ose pa distress (shkatërrim) seksual ka prevalencë të lartë dhe prek 41-47% të grave, në të gjithë popullsinë botërore.

## Cilat janë simptomat kryesore të problemeve seksuale te femrat?

Problemet seksuale te femrat përfshijnë subtype madhore, të specifikuara si probleme në: dëshirën seksuale, zgjimin seksual \*arousal\*, orgazëm, dhimbja në organet seksuale. Funksionimi seksual femëror mund të influencohet nga faktorë të

Deficitet e seksualiteti femëror (FSD), mund të shkaktohen nga çrregullime organike, veçanërisht ato sëmundje, të cilat prekin nervat që marrin pjesë në funksionimin normal seksual. Shkaktari më i zakonshëm i këtyre çrregullimeve seksuale është diabeti.



Mjeku urolog dhe seksolog, Prof. dr. Kim Drasa

shumtë dhe të ndryshëm në thelb: biologjike (me faktorët hormonale dhe çrregullimet pelvikë); psikoseksuale (faktorët emocional dhe afeksonal); faktorë kontekstual (discordancë në lidhjen në çift, problemet shëndetsore të partnerit dhe disfunksioni seksual).

## Kur ndodh disfunksioni seksual te meshkujt?

Disfunksioni seksual tek burrat mund të jetë më shkatërrues tek të rinjtë si dhe tek partneret e tyre kur burrat janë të vjetër në moshë. Adultët e rinj, e kanë më të pranueshme për të vepruar, për të normalizuar lidhjen intime në çift, sepse janë në pikun e produktivitimit seksual të tyre. Çrregullimet seksuale janë zbuluar se janë të lidhura me perceptimet negative të intimitetit në çift dhe kjo mund të jetë një faktor i panjohur, duke kontribuar drejt rritjes së prevalencës të vështirësive në çift.

## Cili është lloji më i zakonshëm i këtyre çrregullimeve?

Dysfunksioni erectile (ED) është një nga çrregullimet më tepër të zakonshme te burrat. Në studimin në Massachusetts, 52% e burrave, nga moshë 40-70 vjeç, kishin patur ED. Në studimin në komunitetin në Boston, prevalenca ishte 22% në meshkujt e moshës 30-70 vjeç. Në studimin tonë, 17.5% e pacientëve kishin ED në stadin e moderuar deri tek e mesme. Disa studime epidemiologjike si dhe studimi jonë ka treguar se funksionimi normal tek gratë është i ndikuar në shumë pika ku ato perceptojnë, nuhasin dysfunksionin erektil tek partneret e tyre. Kjo duket qartë sepse në rastet kur burrat janë mjekuar për ED dhe mjekimi ka patur rezultat në përmirësimin e ED të burrave, ka ndikuar për mirë, në aspektin e gjerë të funksionimit seksual tek gratë e tyre, të cilat nuk

janë mjekuar dhe ky përmirësim u pa aq mirë, në përmirësimin e cilësisë së jetës, në çift. Evidencimi i të dhënave sugjerojnë se funksioni erectile i burrave dhe funksionimi seksual femëror, janë të ndërlidhura, brenda kontekstit të çiftit. Cilat ishin rezultatet e studimit tuaj të paraqitura në Las Vegas?

Studimi që paraqita në Las Vegas, pati qëllimin për të vlerësuar lidhjen midis funksionit seksual femëror dhe funksionit të ereksionit të partnerit të tyre. Ky studim përfshiu 359 çifte. Femrat ishin midis moshës 18-70 vjeç dhe meshkujt midis moshës 23-75 vjeç. Pyetësori femëror \*FSFI\* paraqiti se 39.7% (142 femra) kishin vështirësi seksuale. Pyetësori mashkullor \*IIEF\* paraqiti se 17.5% (63 burra) kishin dysfunksion erektil të moderuar deri tek stadi i mesëm. Burrat me çrregullime të ereksionit ishin të moshave mbi/baras 60 vjeç dhe më shumë referuan se kishin derdhje sperme të parakohshme si dhe ulje të kënaqësisë seksuale. Partneret femra të cilat kishin partnerin e tyre me problem të ED, ishin para një rreziku për të patur edhe ato çrregullime seksuale \*FSD\* aq sa diferenca seksuale e tyre paraqitej në këto aspekte: Arousal, Orgasm, Libido, Dhimbje Seksuale.

Konkluzioni ishte se funksioni seksual femëror ka lidhje, në raport të drejtë me funksionin seksual të ereksionit të partnerit mashkullor.

## Si ndikon çrregullimi seksual te partneri?

Kur njëri nga partnerët seksualë ka ulje dhe çrregullime të funksionit seksual, do të ndikojë patjetër negativisht edhe tek partneri/ja. Partnerit apo partneres nuk ju shkon mendja për të kryer marrëdhënie seksuale për kohë të gjatë duke kaluar ciklin normal, që kanë pasur deri në atë moment. Thëksoj se në çdo kongres dhe në çdo libër për probleme seksuale paraqiten studime dhe metoda mjekimi për të ruajtur lidhjen intime të familjeve të shëndosha moralisht, të cilat nuk kanë tradhti bashkëshortore.



Mjeku popullor: Kujdes, nëse nuk trajtohet në kohë mund të dëmtojë veshkat

Voltiza Duro

Pothuajse të gjithë njerëzit kanë kaluar sëmundjen e infeksioneve në bajame një herë në jetë. Është një sëmundje që kap lehtësisht shumë njerëz për shkak se është lehtësisht e përhapur nëse ndani ambiente të përbashkëta me personat e prekur. Sigurisht që më shpejt ndikohen fëmijët e vegjël deri në moshën 13-15 vjeç, kur kjo sëmundje fillon të kalojë pasi trupi fiton imunitet. Mund t'i përsëritet ndonjëherë pas kësaj gjatë jetës, por nuk kalon në kronike. Është një sëmundje e trashëguar, nëse njëri nga prindërit e ka kaluar i kalon edhe fëmijëve.

#### SIMPTOMAT

Infeksionet e bajameve shkaktojnë temperaturë dhe gjendje lodhjeje e këputje, vështirësi në frymëmarrje dhe në kalimin e ushqimit. Infeksiioni mund të kalojë deri në kocka dhe të krijojë shumë më shumë probleme në moshë të rritur pasi mund të shkaktojë artrit, dhe dhimbje të forta të kockave, ndjeshmëri të madhe ndaj të ftohtit në dimër etj. Por nëse merren hapat e duhura për t'i ndaluar këto pasoja atëherë ato kalojnë pa probleme shqetësuese, dhe këtu nuk përfshihet heqja e bajameve.

#### SHKAKTARËT

Shkaku i parë është trashëgimia, kjo lloj sëmundjeje kalohet nga brezi në brez, dhe i bën individët që e kanë në gjenet e tyre këtë 'dobësi' ndaj kësaj sëmundjeje, më të dobët ndaj agjentëve të mjedisive rrethues dhe ndaj ndryshimit të temperaturave sidomos në moshë të re. Gjithashtu, infeksionet e bajameve shkaktohen edhe nga viruset e bakteret e ndryshme që qarkullojnë në ajër, apo që merren me anë të ushqimeve e mjedisit rrethues. Fëmija mund ta marrë infeksionin në kopsht, shkollë apo mjedis publike dhe kështu mund të shkojë në shtëpi, nëse do të përdorë të njëjtat gota, apo lugë me pjesëtarët e tjerë; ka shumë mundësi që ata që e kanë imunitetin më të dobësuar të preken nga infeksioni.

#### DIAGNOSTIKIMI

Për të dalluar nëse fëmija juaj ka infeksion në bajame vërehet ngjyra e fytyrës, nëse është e kuqe

# Ylli Merja:

## Infeksionet e bajameve, si t'i kuroni me bimë mjekësore

*"Përdorni mjaltin, hudhurat e sodën e bukës"*



Ylli Merja

zona e bajameve atëherë sapo ka filluar inflamacioni. Nëse dallohen zona të bardha rrethore, ato janë vatra infeksioni dhe tregojnë se infeksioni është më i avancuar dhe është më i vështirë për tu trajtuar. Në këto raste shoqërohet me temperaturë të lartë. Infeksionet në bajame shkaktojnë si fillim djegie të fytyrës, ethe, e më tej humbje oreksi, dhimbje koke dhe fryrje të gjëndrave limfatike në qafë dhe probleme me kapërcimin e ushqimit. Bakteret si Stafilokoku ose Streptokoku janë shumë të rrezikshme pasi

këto të dyja mund të kalojnë edhe në kocka, apo të shkaktojnë infeksion në veshka. Prandaj nëse e keni bërë mbjelljen edhe e keni konstatuar që keni Stafilokok apo Strep-tokok, sidomos tek fëmijët duhen marrë masa urgjente për kurimin e sëmundjes. Nëse kalon shumë kohë që fëmija është me temperaturë, infeksioni mund të kalojë në kocka. Infeksioni në bajame mund të shkaktohet edhe nga viruse si influenza, e stimulohet nga myku në gojë apo në zorrë, pasi e bën mjedisin më të lehtë për t'u zh-

villuar sëmundje të ndryshme.

#### PARANDALIMI

Për t'i parandaluar infeksionet e bajameve duhet të keni kujdes me higjienën e përgjithshme. Lani duart, fytyrën shpesh para ngrënies, pas teshtitjes ose kollitjes.


Fëmijët duhet të lajnë duart sapo vijnë nga kopshti, shkolla, dhe rrobat që përdoren në ambiente publike si dhe konsumoni ushqime që përmbajnë vitaminë C të cilat rritin imunitetin, si portokalli, kivi etj. Gjithashtu konsumoni ushqime me antioksidantë si shega.

Përdorimi i këtyre mënyrave alternative është njësoj si të bëni një operacion të bajameve, por pa i hequr ato! Më poshtë përkruhen disa hapa, ju mund të zgjidhni disa prej tyre që janë më të përshtatshme për tipin e fëmijës suaj, pasi jo çdo mënyre



e përshkruar mund të durohet nga çdo fëmijë. Por çdo mënyrë e përshkruar është 100% efektive në largimin e infeksionit. **SI TË VEPROJMË PËR KURIMIN E BAJAMEVE:**

Lyejmë lehtë bajamet me sodë buke, mjaltë dhe hudhër të përziera së bashku nga brenda. Lyejmë qafën me hudhra të shtypura mirë. Kjo ndihmon në qetësimin e gjëndrave të fryra. Pihen 3 herë në ditë filxhan kafe/çaji me përzierjen e mëposhtme duke hedhur në çdo filxhan çaji, për moshën deri në 5 vjeç, 4-5 pika propolis blote, ndër-sa për më të rriturit 10 pika propolis.



**M**arrja e vendimit për të filluar pal estrën shoqërohet me pritshmëritë tona për të patur rezultate sa më shpejt. Por jo gjithmonë ne marrim rezultate ashtu si mund të kishim menduar. Kjo është edhe një nga arsyet që shumë persona e ndërpresin aktivitetin fizik, pasi nuk kanë më motivim për të vazhduar. Më poshtë po japim disa këshilla shumë praktike në momentin që shkoni për herë të parë në një palestër.

**1. MOS QENDRONI INDIFERENT**

Palestrat janë vende që frekuentohen nga shumë njerëz dhe instruktori nuk mund të ketë gjithmonë mundësi t'ju ndjekë në gjithë procesin e stërvitjes. Bëni pyetje, mos qëndroni indiferent. Fakti që instruktori nuk po ju kushton vëmendje, nuk do të thotë se po ju neglizhon ju personalisht.

**2. PERCAKTONI MËNYRËN E STËRVITJES**

Arsyeja kryesore që ne nuk marrim rezultate është mënyra e gabuar e stërvitjes. Nga padija në stërvitimi ashtu si na ofrohet pa menduar nëse ajo është mënyra duhur. E keni pyetur ndonjëherë veten për çfarë po stërviteni? Po stërviteni për të humbur peshë, për t'u tonifikuar, për të shtuar masë muskulare, apo thjesht për qenë të shëndetshëm? Vetëm pasi t'i jeni përgjigjur kësaj pyetje mund të zgjidhni dhe mënyrën e duhur të stërvitjes duke u konsultuar me instruktoren.

**3. USHQEHUNI MIRË**

Çfarë shikoni në pasqyrë

# Këshilla për të marrë rezultate maksimale nga palestra

është 80% reflektim i asaj që ne hamë, dhe 20% bazohet te aktiviteti fizik. Prandaj kushtojini rëndësi ushqimit. Nuk do mundet të merrni rezultate nga palestra nëse nuk ushqeheni shëndetshëm, sado të jeni duke u lodhur dhe stërvitur.


**4. USHTRONI TË GJITHË PJESËT E TRUPIT**

Bëni një program stërvitor duke u konsultuar me instruktoren dhe qëndroni besnikë në rutinën tuaj stërvitore. Nëse ndërrohen mënyrën e stërvitjes sa herë shkon në palestër dhe ushtrohesh pa plan, rezultatet janë akoma larg. Një tjetër gjë shumë e rëndësishme që do

doja t'ju tosha është se duhet të ushtroni çdo pjesë të trupit. Aktiviteti fizik duhet koordinuar, nuk mund të filloni palestrën me mendimin për të stërvitur vetëm këmbët apo për të krijuar vetëm fundshpinë. Nëse e nisni me këtë mendim, shumë shpejt edhe do e braktisni palestrën. Unë personalisht i kam ditët e ndara. Të hënën ushtroj këmbët, të martën krahët, një ditë e kam kardio dhe një ditë e kam ditë force, ku punoj më shumë se herët e tjera.

**5. VËSHITËRËSO SHKALLËN E STËRVITJES**

Ndodh që të keni marrë rezultate në fillim kur keni filluar pal-



estrën dhe më pas trupi nuk ka ndryshuar më. Në këtë rast për të marrë më shumë rezultate duhet të vështirësoni ushtrimet, të shtoni akoma më shumë peshë. Me kalimin e kohës shkal-

la e vështirësisë së ushtrimeve duhet të vijë duke u rritur në mënyrë graduale. Që të keni progres duhet të bëni progres në ushtrime.

**6. MOS U FRIKËSONI NGA PESHAT**

Vajzat janë ato që i trembin më shumë ushtrimet me peshë. Jo se mendojnë se nuk mundën ti realizojnë, por mendojnë se nëse ushtrohen me peshë do t'ju krijohen muskuj të ekzagjeruar dhe një fizik mashkullorë. Kjo nuk është e vërtetën aspak. Prandaj stërvituni me peshë sa më shumë. Ushtrimet e forcës janë ato që japin rezultate të pabesueshme. Të gjitha vajzat me trupa me forma të theksuara dhe muskuj stërviten me peshë.

**7. MOS U DORËZONI**

Mos u dorëzoni. Rezultatet duan kohën e tyre. Vazhdoni stërvituni sistematikisht dhe prisni të shijoni suksesin, i cili më besoni, vjen.





# Këshilla



## Luftoni gripin e të ftohtin me bimën e shtogut

Shtogu është një nga bimët më të lashta të kësaj toke. Emri shkencor i shtogut që përdoret gjerësisht për motive mjekësore është Sambucus nigra. Vlerat shëndetësore të shtogut përfshijnë: shërimin e të ftohtit, virozave, sinozitit, dhimbjeve nervore, inflamacionit, lodhjes kronike, alergjive dhe konstipacionit. Nëse shtogu përdoret brenda 48 orëve të para të simptomave, atëherë ekstrakti i tij arrin të shkurtojë ndjeshëm kohëzgjatjen e gripit. Por nuk mbaron me kaq.

Nëse flasim për fuqinë e antioksidantëve që përmban shtogu, atëherë duhet të dini se kjo bimë përmban më shumë flavonoidë se boronicat, manat goxhi, boronicat e kuqe dhe manaferrat.

### LUFTON TË FTOHTIN DHE GRIPIN

Shtogu forcon sistemin imunitar në mënyrë natyrale. Kokrrat e tij përmbajnë substanca kimike të quajtura anthocianidinë, të cilat kanë efekte stimuluese të sistemit imunitar. Ekstrakti i shtogut është i sigurt në përdorim, efikas dhe një al-

ternativë e lirë për të gjitha trajtimet e simptomave të gripit dhe të ftohtit.

### KUNDER INFEKSIONEVE NË SINUSE

Shtogu ka vlera të pakundërshtueshme kundër inflamacionit falë përmbajtjes së madhe të antioksidantëve. Infekcionet e sinusit shkaktohen nga inflamacioni i mukozës së rrugëve të frymëmarrjes.

Kjo bimë që lufton virozat është premtuese si një kurë natyrale kundër këtyre infeksioneve.

### UL SHEQERNAT NË GJAK

Lulja dhe kokrrat e shtogut janë përdorur tradicionalisht kundër diabetit. Studimet kanë konfirmuar se ekstraktet e shtogut stimulojnë metabolismin e glukozës dhe sekretimin e insulinës, duke ulur kështu nivelet e sheqerit në gjak.

### DIURETIK NATYRAL

Shtogu promovon lëvizjet e zorrëve dhe urinimin. Studimet kanë treguar se shtogu ose varieteti Sambucus ka një rol natyral diuretik, që do të thotë se stimulon urinimin. Mjekët rekomandojnë përdorimin e

substancave diuretike kur organizmi ruan shumë lëngje. Një problem i tillë vërehet më shumë tek të rriturit dhe të moshuarit.

### MBAN LËKURËN TË SHËNDETSHME

Shtogu ka arritur të bëhet pjesë e industrisë së kozmetikës për shumë arsye. Bioflavonoidët dhe antioksidantët së bashku me vitaminën A, e bëjnë atë të jashtëzakonshëm për shëndetin e lëkurës. Studiuesit janë të mendimit që shumë prej përbërësve të shtogut ndihmojnë lëkurën të qëndrojë e shëndetshme.

### LEHTËSON ALERGJITË

Lulet e bimës së shtogut janë pjesë e kurave natyrale bimore kundër alergjive. Duke qenë se alergjitë e stërmundojnë sistemin imunitar dhe shkaktojnë inflamacione të ndryshme, shtogu kundërpërgjigjet duke e forcur sistemin imunitar dhe qetësuar inflamacionin, rrjedhimisht duke lehtësuar alergjitë. Kur bëhet fjalë për të ftohtin, virozat dhe problemet e tjera me frymëmarrjen, duhet të përdorni shurrupin e shtogut. Në treg mund të gjeni marka cilësore të këtij shurrupi, ose mund ta përgatitsi vetë atë në kushtet e shtëpisë.



## Vlerat e mrekullueshme të ftoit

Ftoin e përdorin për reçel, ëmbëlsira, puding, gliko, por edhe në mënyra të ngjashme me dardhën. Vlerat e vërteta të ftoit gjenden jo vetëm të lëkura, por edhe tek tulli i brendshëm që është i mbushur me ushqyes të rëndësishëm, vitamina, minerale, antioksidantë dhe fibrë. Me ndihmën e pak sheqer ose edhe të mjaltit, fruti merr një shije fantastike. Ndihton me rënie në peshë. Ftoi ka pak kalori, kripë dhe yndyrë. Nga ana tjetër, është i mbushur me fibra dhe vitaminë C.

Ndaj nuk keni asnjë pengesë që ta përfshini në planet tuaja për një dietë të shëndetshme. Ftonjtë mund të piqen ose të zihen për t'i dhënë nuanca të tjera shijes madhështore të tij. Ka veti antibakteriale

Shfrytëzoni farat e ftoit. Ziejini në ujë, kullojeni dhe lëreni lëngun të ftohet. Përdoreni për të luftuar erën e keqe të gojës, shëruar fythin dhe lëndimet e ndryshme në gojë. Mund ta përdorni edhe direkt në lëkurë për ta bërë atë më të lëmuar dhe shëruar njollat.

Ngrënia e ftoit parandalon virozat dhe çrregullime të tjera. Ftoi mund të ndihmojë në shërimin e ulçerës peptike, zvogëlon problemet me zorrët dhe parandalon diarenë sepse në të vërtetë ftoi ndihmon me tretjen për shkak të përmbajtjes së lartë të fibrës. Reçeli i ftoit kombinohet mjaft mirë me mishin dhe djathin, pasi e bën më të lehtë përthithjen e këtyre proteinave. Ftoi përmban fibrën e tretshme që njihet për aftësitë e saj në uljen e nivelit të kolesterolit.

Rrjedhimisht, ftoi mbron nga sëmundjet e zemrës, forcon arteriet dhe e bën zemrën më të fortë. Kaliumi që gjendet tek ftoi ndihmon në uljen e tensionit të gjakut. Përmbajtja e lartë e hekurit tek ftoi e bën këtë frut të shkëlqyeshëm për parandalimin e anemisë së bashku me një sërë problemesh të gjakut. I bën mirë sistemit imunitar. Ftoi ka vitaminë C me tepriçë e kjo vitaminë e bën atë një mburojë fantastike për sistemin imunitar. Për më tepër ftoi ka edhe veti të mrekullueshme kundër plakjes. Si çdo frut tjetër, ftoi është i mbushur me antioksidantë që luftojnë radikalet e lira në trup duke ndaluar tendencat e trupit për t'u prekur nga qelizat e dëmshme. Arsyet për të konsumuar ftoin janë të shumta, justifikimet për mos ta konsumuar atë nuk kanë vlerë.

## FESTIVALI I TEATROVE



"VETEVRASESË"



# Kritika krijon armiqësi, përplasje në debatin artistik

Fatmira Nikolli

Kullat ju, teatrin na. Aludi mi i kthimit të "Art Turbinës" në Teatër Kombëtar. Një kryeministër i veshur në stilin e shefit të qeverisë Edi Rama dhe deputetët e tij si imitues të stilit të veshjes e sjelljes. Kakofonia parlamentare, sherrret deri në grushte, shantazhet në emër të votimit të buxhetit duke kujtuar mëkatet e palës tjetër. Gjuha e dhunshme, sjellja e dhunshme, harbutllëku, korrupsioni, e mandej festat e përbashkëta. Shfaqja "Gomari i Babatasit" sjell në Festivalin Mbarëkombëtar të teatrove nga "Migjeni" i Shkodrës në më shumë se 1 orë e 30 minuta skanoni shoqërimin shqiptarë duke bërë që përmes tekstit e gjuhës së At Fishtës, përshatur me problematikën e tanishme si çështje e shembjes së teatrit dhe ndërtimit të një të riu duke bërë muzeun e Fishtës teatrin e danezitet, vetë arkitekti danez, marrëveshja e detit, rruga e Kukësit apo ajo e Elbasanit, papunësia e jo vetëm erdhën të gjitha duke ngritur publikun në këmbë e duke treguar se si bëhen deputetët politikanë, si qëndrojnë në detyrë, si abuzojnë e si përdoren. Aktorët nuk qenë të tërë në lartësinë e rolit, shpesh disa syresh nuk kuptoheshin çfarë thoshin, por jo prej dialektit, por në tërësinë e vet shfaqja që e fortë. Në kuadër të debatit artistik të festivalit u fol për të gjitha shfaqjet, herë me ngurrim e herë më me qartësi, herë me frikë nga hatërbetjet e herë më ballazi. Takimi u moderua nga Hervin Çuli në cilësinë e organizatorit.

## 'MEDEA' MES VALLES E TALENTEVE

Kritiku Miho Gjini tha për "Medean" e sjellë në Festivalin Mbarëkombëtar të Teatrove nga Teatri Kombëtar Eksperimental se me të u përballëm me ngjarje të rëndësishme të festivalit, si prurje interesante. "E kemi parë e lexuar dhe jemi kureshtarë për ta parë në skenë. Ishte varianti bashkëkohës

*Kita: Shfaqja e Shkodrës shumë e politizuar, shfaqja ime kishte probleme*



"Nana"

i Medeas. Kam parë disa versione në Athinë në një tjetër pamje e vështrim regjisorial. Befas pashë një inskenim të ri e interesant që e sjell më afër kohës sonë. E sjell vetvetiu deklamacioni e komunikimi me sallën". Sipas Gjinit, nuk duhet të ndalim te miti i Euripidit, por te interpretimi i Luiza Xhuvanit që bën Medean të sajën. "Ka

njëfarë dhimbjeje në shpirt kur arrin ta kryejë këtë goftë edhe me pendesë të vagëlluar. Pashë një kor jo tipik statik si ato grekë, por një personazh që lind nga kori. Tri personazhe solidë si Jasoni i Trebickës, apo personazhi i Zhustit". Aktorja Adriana Tolka tha se pjesë e korit ka qenë festë "sepse ke mundësinë të shfaqesh në dimen-

*Altin Basha: Politizimi? A kanë këto problemet e shoqërisë shqiptare?*

sione të ndryshme. Ke anën plastike e anën muzikore". Ndër të pakët që jep vlerësime dhe kritika, aktorja Zamira Kita tha se në këto diskutime nuk thuhet të vërtetat. "I takojmë jashtë kolegët e kur bëjmë vërejtje na mërzhiten. Kam frikë të flas se kolegët na mërzhiten e nuk flasin. Shfaqjet nuk kanë qenë në nivelin që i takojnë festivalit. Ballafaquam forcat se të gjitha shfaqjet nuk kanë qenë të mira. Por "Medea" ka qenë një shfaqje impresionuse". Nga ana e tij regjisori Armando Bora tha se bashkohej me mendimin e Mihos e Kitës. "Në Butrint vinin trupa të mira e emra të mirë. Kemi parë "Prometeun e lidhur". Te "Medea" nuk pashë statizmin. Kishte kode në lëvizje. Do doja të kishte më shumë detaje në 1 orë e 40 minuta. Dera u hap disa herë në mënyrë banale dhe e humbi simbolikën. Pjesa i flet aktualitetit për pushtetarët arrogantë. Por nuk i rrëshqasim dot dhimbjes për dy fëmijë. Kërcimi i korit që për mua i tepruar, dukej si valle popullore. Mua vallja m'u duk si shqiptare.

Kori që i unifikuar".

## "BABAI" ME RESHAT ARBANËN

Pjesa me regji të Spiro Dunit mori vlerësime e kritika. Miho Gjini tha se pjesa të shoqëron e të godet e të forcon shijen e mirë të teatrit e ndërmjet veten mirë kur flet shpirti i aktorit Reshat Arbana. Duket se ai interpreton vetveten. Dikush në dekadencë e në fund të jetës, kur afron vdekja e vetëdijja ulet, skleroza e mposht njeriun. Reshati bluaz vetveten dhimbshëm në skenë në mënyrë tragjike. Ndofta për herë të parë e shoh Arbabanë në një zbritje në shtratin e vet aktorial e tepër njerëzor. Në këtë vetmi e gjendje inerte, e lë mendja, e lënë njerëzit e lë shtëpia. Ai zgjon diçka të bukur: njeriun që s'do të vdesë. Kjo është diçka njerëzore dhe shumë e bukur. E uroj Dunin që diti ta bëjë". Për të qenë më koncize dhe pa i thënë duke i thënë, Zamira Kita u shpreh se kërkonte falje për atë që do të thoshte. "Asgjë tjetër në këtë shfaqje nuk vjen në nivelin e Reshat Arbanës", qe fraza me të cilën nga tërë pjesa veçoi aktorin e njohur. Për këtë pjesë, fjalën e mori Alfred Trebicka. Duke falënderuar prof. Reshatin si spektator e qytetar për emocionin dhe atë skanerin që solli me personazhin e vet në aspektin social, Trebicka tha se pa jo një përpëlajtje të Reshatit, por një krijim të tijin mirëfilli aktoresk. "Një rol të ndërtuar gati-gati perfekt. Jo që është vetja, por është rol. Rol i ndërtuar perfekt në të gjitha ato elementë e komponentë që duhet. Lexoje në të plane e nëntekste. Një proces perfekt. Spiro ka finesë në rrokjen e dramaturgut për ndërtimin e tërë veprës. Qe një monodramë me pesë aktorë. Një vërejtje për prof. Shatin: ky na e punoi se duhet të luajmë edhe 30 vjet që të jemi në këtë nivel kur të vijmë në moshën e tij. Uroj që festivalin tjetër të jenë të gjitha shfaqjet si Babai".

## Ndahen çmimet e Festivalit Mbarëkombëtar të Teatrit

Janë ndarë mbrëmë në arTurbina Çmimet e Festivalit pas 8 ditësh me 14 shfaqje. Çmimet shkuan si më poshtë

1. Çmimi "Aktori i ri më i mirë" u dha për Kristian Koroveshin tek shfaqja "Medea".
2. Çmimi "Aktorja e re më e mirë" është Hajat Toçilla.
3. Çmimi "Kostumogafia më e mirë", për Sofi Kara tek "Medea".
4. Çmimi "Skenografia më e mirë", Mentor Berisha tek shfaqja "Ata që ikin".
5. Çmimi "Aktori joprotagonist më i mirë për" Shkëlzen Veseli tek shfaqja "Kalogula".
6. Çmimi "Aktorja joprotagoniste më e mirë", për Gresa Pallaska tek shfaqja "Ata që ikin".
7. Çmimi për "Aktorin protagonist më të mirë", Reshat Arbana tek "Babai".
8. Çmimi për "Aktoren më të mirë protagoniste" e mori Luiza Xhuvani
9. Çmimi special i karrierës shkoi për Roza Anagnostin.
10. Çmimi "Regjia më e mirë", Altin Basha tek "Gomari i Babatasit".
11. Çmimi "Shfaqja më e mirë" shkoi për "Vdekja e Dantonit" me regji te Dino Mustafiç.



*Kritiku Miho Gjini ngurron të bëjë kritikë, jep vetëm anën pozitive të pjesëve teatrale*



Gomari i Babatasit



Për shfaqjen "Nana" të Ulqinit nuk u fol gjatë meqë ata nuk ishin të pranishëm.

**"ATA QË IKIN", NNDARJA REGJI AKTORË**

Shfaqja e Prizrenit "Ata që ikin" pati një efekt në mëdyshe. Kritiku Miho Gjini u shpreh së pari, që nuk do fliste gjatë, sepse mezi e ka dëgjuar: "Ndodhemi më një mëdyshe ku ekzistenca e mosekzistenca janë të pranishme tërë kohës. Trajtimi absurd e surrealist është paraqitur si një vegim përshtjellues. I sheh të ezauruara mjetet shprehëse të teatrit. Pashë regji ndërsa aktorët m'u rrafshuan. Jo se nuk ishin mirë po se kaq arrita të kap". Drejtori i Teatrit Kombëtar si organizator i festivalit sqaroi se e ka ftuar Prizrenin, sepse 3-4 vitet e fundit Prizreni i është dukur si një nga trupat më të mira. Për këtë shfaqje Alfred Trebicka së pari, uroi Fetah Paçarizin se Prizreni ka bërë një hop të madh. Sa për shfaqjen ai tha se unifikimi i regjisë me gjithë elementët e tjerë do ta ngrinte në nivel më të lartë shfaqjen. "Mua më duket një regji në vetvete e ndërtaur saktë, por kishte një distancë me regjisë e imazhit regjisorial e ata që quhen aktorë e janë në skenë. Kjo e bënte

shfaqjen të ftohtë, distanca mes regjisë e aktorëve. Është rëndë për të bërë regji dhe në një moment regjisor harron se komponenti kryesor është aktori. Sheh regji të mirë, aktorët aktojnë po s'kanë lidhje me këtë. E pashë edhe te Prishtina, se ishin të ndara. Është një vërejtje që duhet artikuluar", tha Trebicka.

**"VETËVRASËSI", KITA BËN AUTOKRITIKË**

Duke qenë se është ndër të pakat të jep vlerësime e kritike, që kur doli në panel përkrah Çulit tha se do e bëjë po vetë kritikën për shfaqjen e saj, sepse po nuk foli ajo të tërë do heshtin. Kritiku Miho Gjini tha se është një ndër veprat interesante për të cilat kanë nevojë festivalat. "Është dramë satirë. Vepër me trauma të njeriut të aftë po që s'ka këllqe të rezistojë. Trupa e Korçës dhe e TK i kishte këllqet për ta trajtuar. Trupa dhe regjia që RUSHITI i imponohet publikut tonë arrijn të kalojë nga drama në humor në satirë e në grotesk. Neritan Liçaj ka natyrshmëri të madhe me rrezatimin e vet. Zamira Kita shumë e mirë e shpërthen rolin dhe e merr publikun pas vetes", tha ai. Zamira u shpreh se Miho

Gjini herën e parë foli shumë mirë për problematikat e shfaqjeve por tani më duket se e kanë zënë jash-të dhe e kanë trembur. "Shfaqja ka shumë problematika edhe pse ne e duam, sepse nëna e do edhe fëmijën e sëmurë. Këtu në shfaqja na ka dalë më keq se në Korçë. Aktorët nuk u ruajtën si atje. Aktorët flisnin mbi njëri-tjetrin këtu. Krijuan kafkafoni. Publiku s'e kuptoi mirë shfaqjen. Ndaj le ta kuptojmë në që ta kuptojmë mirë publiku. Unë e di vetë që ndërm me regjisorë të mirë kam ndërshuar nga vetja ndaj le të mos fluturojmë se nuk jemi të shkëlqyer. Ja sheshi e ja mejdani. Të jemi koshientë për atë që shikojmë".

**"GOMARI I BABATASIT", MES POLITIKËS E MOSKUPTIMIT**

Për shfaqjen e shkruar nga Gjergj Fishta me regji të Altin Bashës, e vënë më skenë nga teatri Migjeni ka pasur vlerësime në tërësi. Miho Gjini tha se "e ndje veten të vështirë. Jam marrë gjatë me kritikën. Tani vë re që Migjeni mbi jeton dhe është një nga teatrot që përcjell një forcë të brendshme interpretuese. Ka forcë e komunikim. E sjell në ditët e sotme veprën. Ak-

tualizimi nuk bëhet me trajtë banale. Këtu ka qëlluar më në shenjë Altini dhe i ka harmonizuar. Shfaqja godet. Ka një grupim aktorësh që nuk qëndrojnë në vargjet e Fishtës që nuk përmbahen. Zyliha Miloti përcjell bukur vargjet e Fishtës e krijojnë atë që i duhet teatrit", tha Gjini. Por duket se ata që trembën Miho Gjinin i dhanë forcë të tjerëve. Adriana Tolka tha se shfaqja e përfshiu. "Mora imazhet që donin të jepnin regia dhe aktorët. Shkonte me pompozitetin e idesë. M'u krijua përshtypja se Zyliha Miloti në fillim nuk ndihej mirë. U reflektua sikur donte vetëm ta mbaronte. Më tej në shfaqje, shpesh për ritmin humbte tekstin. Pierin Vlasi po ashtu binte në këtë gabim. Aktorët i rrëmbente fraza dhe gabonin ritmin dhe humbte tekstin në 50%. Unë jam e rrahur me dialektin dhe nuk e kam për dialektin, por fjala humbte dhe frazën aktori duhet ta përcjellë qartë gjithsesi", tha Tolka për "Gomarin e Babatasit". Aktorja Rita Gjeka njëherësh drejtoreshë e Migjenit vërejtje se festivali duhet me qenë festë dhe se pretendon me u dashtë ma fort. "Unë e di ç'jam e s'më bëni mirë duke më thënë që jam aktore e madhe. Dua të bëj

punën mirë për aq sa jam. I dua punët më të mira se të miat dhe e di se cilat janë. Ka pas shfaqje që as shkollat e mesme se bëjnë ashtu". Zamira Kita e nisi duke uruar Ritën e duke vlerësuar Altinin. "Mua m'u duk pak e politizuar më shumë se sa duhet. Orkestra ishte bukur, por nuk u përdor shumë ndoshta mund të bënin diçka edhe ata. Aktorët në disa raste ishin deklamativë, bërtisnin e bënin zhurmë. Nikolinin e vlerësoj. Kishte problematika në deklamim. Isha pak skeptike", tha Kita. Oponencës së Kitës iu përgjigji regjisor Basha. "Është tekst shqip i shkruar para 100 vitesh. E di se do të mund të ishte teksti i fundit nga miliarda tekste. Është trashëgimi kulturore tmerrësisht e rëndësishme. Vetëm strukturimi i veprës ka qenë shumë punë për të parë bashkë dy vepra: Gomari dhe Visku i Babatasit. Linja e debatit ka qenë më vete dhe linja e parlamentit më vete. Ia ka vlejtur mundimi për t'i bashkuar jo për festivalin e as për emrin. Ky është një festival që bashkon Florian Zeller e Fishtën. Unë dua të jap kontribut në dramën shqipe", tha ai për tekstin. Më tej vërejtje se politizimi është i fortë, se ka politizim. "Ka një situatë, e cila në 40 vjet komunizëm e në 30 vite demokraci i ndau artistët, i bëri armiq. I ndau në ngjyra politika, nëse i drejtoesh publikut me sjelljen e politikanëve si abuzimi, arroganca, korrupsioni, trajtimi i pozit dhe i publikës si kopsht personal, ç'problem ka? A janë këto elementë që e shqetësojnë publikun shqiptar? U tha që nuk kuptohej teksti, nuk kuptohej as Shekspiri as Dantja, por kjo s'do të thotë të mos vihen. Teatri duhet të jetë në avantgardë për shumëçka, duhet të ishte për hapjen e dosjeve. Probleme? Dikush nga aktorët bën edhe lapsuse. Por duhet të them se dekorri duhet të montohet një natë para që të kemi mundësi për prova. Ne e montuam atë ditë dhe nuk bëmë dot provë teknike", tha Basha, çka u prit jo pa rezerva nga Çuli si organizator. Mes Çulit dhe Bashës pati njëfarë debati e kakofonie mbi përzgjedhjen e pjesëve, mbi festivalin, nevojën për kritikë, sepse nuk është vetëm Miho Gjini, mbi mospjesëmarrjen e shfaqjeve të trupave private.

Basha shtoi se nuk mund të kuptojë një festival mbarekombëtar pa një tekst të Teki Dervishit, duke ngritur pyetjen: përse duhet të kemi turp për këto? "Ka shumë për të bërë, që nga komisionin i veprave dhe afrimi i dramaturgëve në teatër. Drama nuk zhvillohet po s'e shkruam edhe po s'e vumë në skenë. Një regjisor në shfaqjen e parë edhe të pestë s'do ta gjejsh më te njëjtin nivel kur të ketë bërë 20 shfaqje. Çapaliku ka thënë niveli i dramaturgjisë është njësoj me teatrin shqip. Ka një përpjekje më të mirë për ta glorifikuar aktrimin". Për të dalë tek çështja e politizimit, Basha u shpreh se politizimi është i fortë se ka politizim. Sa i takon debatit Hervin Çuli tha se përveçse Miho Gjinit kemi ftuar edhe disa profesorë nga Kosova edhe Maqedonia, por e kishin të pamundur që të vijin për hir të moshës.

Altin Basha tha se ka djem të rinj që shkruajnë nëpër gazeta për çka Çuli pyeti nëse duhet të merrte atë në telefon. Basha i tha se mund ta merrte. "Përgjastimi i shfaqjeve të skenës së pavarur është gabim. Që të nxjerrësh një përfundim duhet që të shikosh në çdo aspekt", tha Basha

Opinion i Ditës

# Prangat e padrejta në duart e Rexhepit

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... vëllëzërit politikë, policia që duam, prokuroria karagjoze e Arta Markut, mediat e bunkerizuara me para publike, bënë ç'është e mundur për ta fshehur këtë krim.

U desh vetëm një akt kokëkrisur i Emiliano Nuhut, -të cilin Rama u betua se do ta ndjekë hap pas hapi për demin që i shkaktoi-, që rilindja të tërhiqej para presionit publik.

Nëse do të kishim qenë një vend normal, mostra nga Nikla tani do të ishte prej së paku një viti në burg. Por atë e mbrojtën deputetë, kryebashkiakë, shefa policie dhe së fundi gazetarë të tredhur, që e konsiderojnë herezi ndëshkimin e njerëzve me pushtet.

Arrestimi i Rexhep Rrajës nuk është për t'u përshëndetur edhe sepse ai nuk vjen si një pasojë e reflektimit. Rilindja është sjellë njësoj më të gjitha rastet e ngjashme. Ajo është munduar t'i mbrojë kriminelët e saj, të kriojojë alibi për ta deri në çastet e fundit dhe vetëm kur nuk ia ka



dalë të manipulojë publikun është tërhequr me turp.

A nuk veprimi në këtë mënyrë edhe me Habilajt që vazhdonin drogën ndërsa Rama dhe Tahiri burgosnin denonuesin e tyre, Dritan Zaganin?

A nuk ndodhi kështu me Mark Frrokun, të cilit i fshehën deri në fund edhe kërkesën e In-

terpolit për arrestim?

A nuk ndodhi kështu me Kostandin Xhuvanin, që e liruan nga burgu dhe u detyruan ta ndalonin vetëm pasi vrau katër vetë?

A nuk ndodhi kështu me Agron Xhafajn që nuk e dorëzonin në Itali deri sa e çuan pako postale, brenda natës, pasi u

rrezikua nga një skandal më i madh?

A nuk ndodhi kështu me Ervis Roshin, që Rama e shëtiste si klloun me vete, duke thënë se e kishte certifikatën e pastërtisë së virgjër?

Edhe rasti i Rexhep Rrajës nuk bën përjashtim nga kjo vazhde.

Ashtu sikurse pararendësit ata përshkohen nga e njëjta filozofi: të fortët e pushtetit duhen mbrojtur me çdo kusht. Ata do të dorëzohen vetëm nëse krimet e tyre shndërrohen në skandal, që kushton në imazh, më shumë sesa ndihma që japin muskujt dhe armët e tyre.

Pra, në këtë kuptim, drejtësia në rastin e Rexhep Rrajës është përdhunuar dyfish. Sepse ai fillimisht u mbrojt në kundërshtim me ligjin, ndërsa tani po burgoset si pasojë e një vendimi politik për të mos shkallmuar deri në skaj imazhin e kësaj shumice.

Prandaj, në vend që të na duket si fitore, dita e burgosjes së tij mund të konsiderohet pa frikë si një ditë e errët. Një provë se nuk jemi të mbrojtur nga një shtet ligjor, por jemi në duar të një shteti bandit. Të një shteti që po merr përditë e më shumë trajtat e një regjimi. Të një regjimi që është edhe më i rrezikshëm, sepse di të përdorë përveç dhunës edhe manipulimin. Prangat në duart e Rexhep Rrajës janë dëshmi e këtij binomi. Sepse ato japin përshtypjen e gabuar se më në fund drejtësia u v në vend.

Lapsi.al

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



Opinioni *i* Ditës

# Vizita e Thaçit në Ujman shqetësoi tej mase Beogradin

Nga Bekim Shehu

(vijon nga faqja 1)

.... KFOR-i, po vazhdon ta monitorojë situatën në veri.

Vizita e Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi në veri të Kosovës, ngriti shqetësime në Beograd, sa bëri që Presidenti serb Aleksandër Vuçiç të japë urdhër për gatishmëri të ushtrisë serbe ndërsa, në orët e mbrëmjes t'i drejtohet edhe popullit me një fjalim në televizion. Presidenti Tha-i, gjatë kohës që në Prishtinë zhvillohej protesta e Vetëvendosjes kundër një marrëveshjeje Tha-i-Vu-çiç për shkëmbim territori, ai shëtit me një barkë në liqenin e Ujmanit në veri të Kosovës, që është pjesë e bisedave e Kosovë-Serbi. Kjo vizitë e papritur e presidentit në veri sigurohej nga njësite speciale të policisë së Kosovës, ROSU. E pikërisht njësitet ROSU, te liqeni i Ujmanit ishte shqetësimi kryesor i Presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiç.

“Hyrja e forcave speciale të Kosovës, ROSU, ditën e shtunë në veri të Kosovës, përbën sulm të armatosur banditësh”. Me hyrjen e njësiteve speciale ROSU në veri të Kosovës u kërcënua dhe sulmuar paqja. Operacioni përfshiu 110 deri në 130 anëtarë të forcave speciale të Kosovës, të gjithë shqiptarë, që kanë zënë rrugë hyrëse dhe të gjitha objektet pranë Ujmanit, duke keqtrajtuar brutalisht disa persona dhe duke mbajtur peng katër nga ta”, tha Aleksandër Vuçiç.

Më tej ai shtoi se me “dhunën e sotme” janë shkelur disa marrëveshje të mëhershme Kosovë-Serbi.

“Përfaqësuesit e Kosovës treguan se këto marrëveshje nuk i obligojnë ata dhe për më tepër, ata e kanë mbështetjen e aleatëve të tyre perëndimorë. Shqiptarët e armatosur në veri të Kosovës, sipas marrëveshjeve që kemi arritur, mund të shfaqen vetëm me përmirësimin e dy kushteve: me miratimin e NATO-s dhe me pëlqimin e plotë të komunitetit lokal serb. Nuk e di nëse kanë pasur pëlqimin e NATO-s, por kushti i dytë është shkelur plotësisht”, tha presidenti serb Vuçiç.

“Sot autoritetet e Prishtinës për herë të tretë në muajt e fundit, në mënyrën më provokuese të mundshme kanë kërcënua dhe sulmuar paqen dhe është tentuar që nga Serbia të marrin përgjigje, e cila do të mund të përdoret për demonizimin e shtetit tonë, së bashku me pjesëmarrjen e bashkësisë ndërkombëtare”, deklaroi Vuçiç, duke shtuar se “ajo çka ndodhi është dëshmi se ata kanë tentuar të tregojnë që nuk i respektojnë marrëveshjet e Brukselit”.

E nga ana e tyre Forcat Paqeruajtëse të KFOR-it konfirmuan prezencën e njësiteve speciale ROSU në veri të Kosovës, ndërsa,



nuk thanë nëse kanë qenë para-praktisht të njoftuar për vizitën e presidentit në liqenin e Ujmanit. Në një komunikatë për medie, KFOR-it bëri thirrje për qetësi dhe përmajtje.

“Prezencën e policisë së Kosovës në Gazivodë është konfirmuar. Kjo ka qenë pjesë e personelit përgjegjës për mbrojtjen e Presidentit të Kosovës, i cili ka vizituar rajonin e Zubin Potokut. KFOR-i e ka shoqëruar prezencën e njësiteve speciale ROSU dhe ne do të vazh-

dojmë ta monitorojmë situatën me patrulla dhe helikopter”, -thuhet në komunikatën e KFOR-it.

Që njësitë speciale të policisë së Kosovës, ROSU, ishin në shoqërim të Presidentit Tha-i, e konfirmoi edhe ky i fundit. Ndërkohë, në një komunikatë për medie në orët e mbrëmjes së ditës së shtunë (29.09), Presidenti tha se gjatë vizitës në veri “kisha kënaqësinë që në një vizitë krejt rutinë normale të punës, të vizitit pikën kufitare në Bërnjak, të takoj policë kosovarë,

të takoj kufitarët në pikën IBM, të instaluar nga rezultatet e bisedimeve në Bruksel. Ishte një mrekulli t'i shihje të gjithë njerëzit duke punuar, të nacionaliteteve të ndryshme, shqiptarë, serbë e boshnjakë, të gjithë pa dallime në shërbim të rendit, në shërbim të ligjit, në shërbim të së mirës, në shërbim të lëvizjes së lirë të njerëzve, të mallrave, pra një gjendje krejt normale”, -tha presidenti Thaçi.

Sidoqoftë, dialogu Kosovë-Serbi i paralajmëruar që të hyjë në fazën finale të një marrëveshjeje përfundimtare sa vjen e vështirësohet me deklaratat dhe veprimet e autoriteteve të Beogradit dhe Prishtinës. Tre javë më parë ishte Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiç, i cili gjatë vizitës në Kosovë mbajti konferencë mbi digën e liqenit të Ujmanit, duke përcjellë kështu mesazhin “për rëndësinë që ka ky liqen për Serbinë”. Kjo nxiti reagimin e Prishtinës zyrtare duke e cilësuar të papranueshme dhe jo të zakonshme sipas tyre që “një president i një shteti fqinj të flasë për asetet e Kosovës, sikurse të ishin të tija”. E Bashkimi Europian nga ana e tij që lehtëson dialogun Kosovë-Serbi edhe kësaj radhe bëri thirrje për përmajtje nga të dyja palët.

“Hyrja e forcave speciale të Kosovës, ROSU, ditën e shtunë në veri të Kosovës, përbën sulm të armatosur banditësh”. Me hyrjen e njësiteve speciale ROSU në veri të Kosovës u kërcënua dhe sulmuar paqja. Operacioni përfshiu 110 deri në 130 anëtarë të forcave speciale të Kosovës, të gjithë shqiptarë, që kanë zënë rrugë hyrëse dhe të gjitha objektet pranë Ujmanit, duke keqtrajtuar brutalisht disa persona dhe duke mbajtur peng katër nga ta”, tha Aleksandër Vuçiç.

## HOROSKOPI

### DASHI

Mos humbisni energjitë duke debatuar për disa çështje të parëndësishme. Përmirësimi i gjendjes financiare do të bëjë që kryeni disa blerje të rëndësishme. Me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj do të kaloni një ditë të mos u harruar.

### DEMI

Do të ndiheni shumë mirë fizikisht, pavarësisht një ditë të lodhshme në punë. Një debat me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj do t'ju shkaktojë tension. Mos ndërmerrni vendime të rixituara, pasi mund të pendoheni shumë shpejt.

### BINJAKET

Do t'ju mungojë shumë dikush që nuk mund të qëndronte pranë jush sot. Ka gjasa që të realizoni planin tuaj për të udhëtuar. Mund të përdorni aftësitë tuaja të fshehura për të përjetuar momente shumë të këndshme.

### GAFORJA

Sot do t'ju rritet besimi në vetvete. Do ta përmirësoni gjendjen tuaj financiare duke mbledhur borxhet që iu kanë të tjerët. Ka gjasa të nisni një lidhje të re romantike, por nuk do të zgjasë shumë.

### LUANI

Përpunimi të kuptoni potencialin tuaj, pasi nuk ju mungon forca, por vullneti. Do të kaloni një ditë relaksuese me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj. Për prindërit e kësaj shenje, dita juaj do të jetë e ngarkuar me fëmijët, por do të kënaqeni pamasa.

### VIRGJERESHA

Sot do të pushtoheni nga energjia dhe entuziazmi. Ka gjasa që gjendja juaj financiare të mos jetë ashtu siç dëshironi, për shkak të disa faturave që do paguani. Sot do të kuptoni që jeni thellësisht të dashuruar.

### PESHORJA

Ka gjasa të vuani nga një dhimbje e vazhdueshme në shpinë. Mos e nënvlerësoni atë nëse shoqërohet me gjendje dobësie. Gjoni kohë për të pushuar pasi është shumë e rëndësishme. Mund të përballeni me një konflikt me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj për shkak të shpenzimeve të tepërta.

### AKREPI

Sjellja juaj sharmante do të tërheqë vëmendjen. Dashuria për partnerin/partneren tuaj do t'ju rritet. Tregohu origjinal gjatë bisedave me të tjerët, pasi nëse nuk tregoheni vetvetja mund të shkaktoni reagime të pakëndshme.

### SHIGJETARI

Nuk është e nevojshme të ankoheni apo të mërziteni për shkak të kushteve të jetesës. Ka gjasa që problemet tuaja financiare të reduktohen, pasi do të jenë prindërit ata që do t'ju mbështesin.

### BRICJAPI

Tregoni më shumë kujdes për shëndetin tuaj. Do të jetë në ngarkuar me punët në shtëpi. Sa i përket anës romantike, nuk do të jetë dita juaj më e mirë. Një i huaj mund të bëhet shkak për konflikt mes jush dhe partnerit/partneres.

### UJORI

Sot do të ndiheni shumë optimist. Miqë do t'ju ftojë të kaloni një mbrëmje të këndshme. Partneri/partnerja juaj do të tregohet shumë mbështetës. Nëse keni bërë plan për të udhëtuar, ka gjasa që të shtyhet për shkak të disa ndryshimeve në axhendën tuaj.

### PESHQIT

Bëri kujdes kur flisni me të tjerët, pasi mund t'i lëndoni. Disa ndryshime në jetën tuaj do t'ju bëjnë shumë të qeshshëm. Bisedat me disa persona të rëndësishëm do t'ju japin ide për plane të reja. Sa i përket jetës bashkëshortore, do të keni nevojë për më shumë hapësirë.

ISH-TRAJNERI KUQEZI



Pas 8 vitesh që ka qenë për herë të fundit në krye të një skuadre në Seria A, ish-trajneri i Kombëtares, Xhani De Biazi, mund të rikthehet në Itali. Siç raportojnë mediat italiane, drejtuesit e Frosinones po mendojnë seriozisht shkarkimin e trajnerit Moreno Longo, teksa ditën e djeshme pësoi humbjen e gjashtë në shtatë takime këtë sezon. Teksa u përfol se mund të shkonte në

De Biazi drejt stolit të Frosinones

krye të kombëtares së Armenisë, tashmë emri i De Biazi lakohet, edhe si trajner i mundshëm te Frosinone. Përkrah De Biazit, përmenden edhe ekrat e tjerë si Xhuzeke Iakini, Davide Nikola apo edhe Masimo Rasteli. Gjithsesi, orët në vijim do të jenë përcaktuese për

emrin e ri në stolin e Frosinones. 62-vjeçari për herë të fundit në Serinë A ka drejtuar Udinesen në sezonin 2009-2010, ndërsa në dhjetor të 2011-ës u emërua trajner i Shqipërisë, eksperiencë të cilës u dha fund më 14 qershor të vitit të kaluar.

KUQEZINJTË E ZVICRËS

Lenjani jep asist, Xhaka titullar, minuta për Fejzullahin

Ermir Lenjani kthehet të luajë përsëri si mesfushor krahu dhe të shenjë në fitoren 3-1 të Sionit në fushën e Lucernës. Futbollisti i përfaqësueses shqiptare, i cili luante në krahun e majtë gjatë periudhës së De Biazit, është pozicionuar në të njëjtin vend edhe nga tekniku i ri i Sionit, Murat Jakin, dhe ka treguar se mund të jetë më vendimtar në këtë rol. Në një ndeshje shumë të mirë, ai ka dhënë asistin për golin e dytë të skuadrës së tij, të realizuar nga Bastien Toma, mesfushori shqiptar që luan në radhët e kësaj skuadre. Ky ifundit dha asistet për dy gola të tjerë të skuadrës së Sionit e cila në këtë mënyrë është larguar nga zona e ftohtë e klasifikimit. Në telashe vazhdon të mbetet Ksamaks, në zonën e ftohtë të klasifikimit por me një rezultat pozitiv nga përballja e sotme ndaj Zyrhit. Ndheshja përfundoi 0-0 dhe në fushën e lojës, që në minutën e 9 hyri Arbënor Fejzullahi, ish-futbollisti i Partizanit, pas dëmtimit të një prej titullarëve. Për mbrojtësin kjo ishte ndeshja e dytë në kampionatin zviceran të futbollit. Ndërkohë, Taulant Xhaka ka luajtur 90 minuta në barazimin 2-2 të Bazelit në fushën e Luganos, ku Alban Ajeti u bë protagonist me një gol dhe një asist.

Presidenti Halili do ta kishte larguar menjëherë pas derbit, por kontrata e mban lidhur



Jeton Selimi

Stuhi bardheblu, Ze Maria i ka orët e numëruara

Braziliani mund të shkarkohet këto ditë

Gjashtë ndeshje të luajtura, 1 fitore, 2 barazime dhe 3 humbje. Në total 5 pikë për një golavarazh prej 5 golash të shënuar dhe 7 të pësuar: Bilanci i Ze Marias te Tirana nuk buzëqesh aspak, ndërsa pas humbjes së pësuar në derbi ndaj Partizanit, pankina e tij është lëkundur më fort se herët e tjera. Humbja në derbi dhemb gjithmonë, por ajo që ka hidhëruar pa masë presidentin Halili dhe ambientin bardheblu ka qenë mungesa e ideve dhe gjendja e lojtarëve, që për minuta të tëra pësuan presionin e të kuqes, të cilët triumfuan me meritë 1-0. Por e vërteta është se krisja mes trajnerit Brazilian dhe presidentit të Tiranës i ka filluesat më herët. Menjëherë pas përfundimit të Kategorisë së Parë, ku bardheblutë u shpallën kampionë, Halili ka qenë i detyruar në të vërtetë apo jo kontratën me Ze Marian. Gjithsesi ngërçi i parë kaloi, por në merkaton e verës pati disa kontradikta për lojtarë të afruar apo të tjerë të munguar, ndërsa edhe pse nisi kampionati, Ze



Maria ka vijuar të kërkojë përforsime në vijën e parë, ndonëse Halili shpesh përsëriti se ekipi është i kompletuar. Megjithatë presidentia bardheblu bëri dhe

një sforcë të fundit me afrimin e Oduamadit, ish-sulmuesi që besohet se do t'i jepte trajnerit brazilian cilësitë që ai kërkonte. Por me përfundimin e javës së

gjashtë, tabela e renditjes flet vetë. 5 pikë, 2 më shumë sesa Luftëtari i vendit të fundit dhe 1 më shumë sesa Kastrioti. Bardheblu me rikthimin në superiore e sho-

hin veten sërish në zonën e ftohtë, aty ku ishin edhe në fund të edicionit 2016-2017, që solli për herë të parë në histori rënien e Tiranës nga kategoria. Ndaj në këto kushte, me mjegull të dendur qark ekipit dhe me hijet e përsëritjes së një tjetër sezoni të keq, Halili mund të vendosë së shkarkojë Ze Marian. Braziliani nuk ka ndërmend të japë dorëheqjen. Ai dhe stafi i tij marrin një pagë të majme dhe nuk duan të heqin dorë prej saj, duke e detyruar Halilin që t'i paguajë rregullisht deri në fund të kontratës. Ndaj situata është e koklavitur, por drejtuesit bardheblu mund të sakrifikojnë shifrat e kontratës për të shpëtuar sezonin, që ka nisur vërtet keq, ndonëse janë luajtur vetëm 6 ndeshje.

LEGJIONARËT

Myrto Uzuni gjen golin e parë në Kroaci

Ish-futbollisti i Laçit, Myrto Uzuni ka gjetur golin e parë me fanellën e Lokomotivës së Zagrebit, ku u transferua në fundin e merkatos së verës. 23-vjeçari ka shënuar golin e dytë në fitoren 0-3 të Lokomotivës në transfertë kundër skuadrës së Goriciës. Fillimisht, ishte shqiptari tjetër, Lirim Kastrati që i dha avantazhin skuadrës së tij, duke shënuar në minutën e 42'. Goli i Uzunit u realizua në minutën e 70', gol që i siguroi tri pikët skuadrës së Lokomotivës. Golin e tretë dhe

të fundi të sfidës e shënoi Halilović dhe Lokomotiva e Zagrebës mori tri pikët e radhës, duke u ngjitur në vend të dytë.

BASHA TITULLAR FIKS TEK ARISI I SELANIKUT

Migjen Basha, mesfushori i kombëtares shqiptare të futbollit, vazhdon të jetë një lojtar kyç te skuadra e Aris në kampionatin grek të futbollit. Mesfushori me shumë eksperiencë luajti sërish si titullar dhe sërish i besua përgjatë gjithë takimit, duke mos u zëvendësuar për asnjë mo-

ment. Arisi priti dje në shtëpi ekipin e Asteras Tripolis, një ndeshje kjo shumë e vështirë për skuadrën e Bashës. Por gjithçka shkoi mirë për ta dhe arritën të marrin një fitore të pastër 2-0. Edhe pse Basha nuk ishte në listën e golashënuesve, ishte shumë deciziv në ruajtjen e balancës para mbrojtjes, duke thyer shumë aksione të kundërshtarit. Me këtë fitore, Aris ngjitet në vend të katërt dhe është në grupin e pretendenteve për titull në kampionatin grek.

Trajneri i Interit shfrenon fantazinë

Spaleti: Në ekip kam një si Roberto Karlos




Interi po kalon një formë mjaft të mirë, ku në dy javë ka arritur të marrë 4 fitore radhazi në kampionat dhe në Ligën e Kampionëve. Në lidhje me këtë ecuri, është entuziazmuar shumë edhe trajneri Luçiano Spaleti i cili pas fitores në shtëpi ndaj Kaljarit, ka vlerësuar maksimalisht futbollistët e tij. Ai është ndalur veçanërisht te mbrojtësi Dalbert Henrike i cili erdhi me shumë bujë te Interi, por nuk po arrin të gjejë minutat e duhura. Megjithatë, Spaleti nuk i kursen elozhet për të, duke e krahasuar edhe me Roberto Karlosin.

Dalbert është rritur shumë si lojtar dhe kjo gjë është kuptuar mirë edhe nga tifozët të cilët e duartrokitën. Në takimin me Kaljarin, ai bëri një ndeshje të madhe, është i shpejtë, lëviz shumë

në fushë. Për të mund të them se ka një të majtë mjaft të fuqishme, si goditjet e Roberto Karlos, por megjithatë duhet të përmirësohet ende", u shpreh Spaleti.

**Fjalëkryqi (1)**



- HORIZONTAL**
- Bëjnë artë me re.
  - Krijoi Arsene Lupin (inic).
  - Janë forma.
  - Në hyrje të plazhit.
  - Kapen të parat.
  - Janë ufot.
  - Mbahen nga ata që i thyejnë.
  - Inicialet e Mascagni-t.
  - Në krye të trupave.
  - Eshtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
  - Pak hemorragji.
  - U shkrua nga Jack London.
  - Institucione Ndërkombëtare Europiane.
  - Scarlet e Bashkë me erën.
  - Janë tituj në ekran.
  - Eric aktor.
  - Kështu e ka syrin vigjilenti
  - Janë nofka.
  - Një provë... inteligjence.
  - Mund të jenë me sahat.


- Një pjesë e naivitetit.
  - Pak imagjinatë.
  - Pikat pa kufij
  - Fillojnë aksionin.
  - Kërkohej nga poetitë.
  - Nota e diapazonit.
  - I prin kolonës.
  - Eshtë filozofie moralit.
  - Ulet në dhomën e lartë.
- VERTIKAL**
- Malet pa kufij.
  - Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
  - Inicialet e Altman.
  - Një sportist që arrin majat
  - Courier ish-kampion i tenisit.
  - Fillojnë testin.
  - Mund të jetë parabolike.
  - Bie me ballë.
  - Carnera, ish-kampion i ringut.
  - Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
  - I kanë rrënjët në tokë.
  - Eshtë pushkë.
  - Brown i Kodi i Da Vinci-t.
  - Takim Brezash Durrës.
  - Ishte lumi i Elizit
  - Eshtë kardinal.
  - Mbyllin një krah.
  - Artikull anglez.
  - Mbyllin fushatat.
  - Partia pa ara.
  - Zola që shkroi Nana
  - Nganjëherë duhen vënë mbi i.
  - Një fjalë kastile
  - Inicialet e Mann shkrimtar.
  - Maiden që këndojnë.
  - Ai i shtatë është kinemaja.
  - Fillojnë arsyetimin.
  - Eshtë nënë e Tironës.
  - Eshtë shahu i fundit.
  - Inicialet e Klee piktor.
  - Dy asa.
  - Mbarojnë fare

**Fjalëkryqi (2)**

- HORIZONTAL:**
- Patricia këngëtare.
  - I vocërr ai i Migjenit
  - Hari spiune.
  - Oyteri i Robespierre.
  - Phineas i famshëm i cirkut.
  - Pak latinisht.
  - Inicilet e Banderas.
  - Janë tek në rrota.
  - Pak efikasitet.
  - Eshtë shkolla fillore.
  - Arrihet duke aderuar
  - Pak iniciativë.
  - Një... art i Don Judd.
  - U kompozua nga Rachmaninov.
  - Diku në qendër.
  - Një është për të lidhur.
  - Jepet për hartim.
  - Sergej, poet i famshëm rus.
  - Veriu pa kufij.

- Mbyllin një tender.
- Një pjesë analogjisë.
- Mjeku pa ju.
- Nisin nga kreu.
- Një rapper i famshëm.
- Një pikë... vaj.
- Në fund majtas.
- Ndizen me një çelës.
- Emri i Delon
- Janë të dërguar specialë

- VERTIKAL**
- Eshtë edhe ai i sheqerit.
  - Eshtë për medaljen e parë.
  - Një Pop i Andy Warhol.
  - Sapo fillojnë.
  - Qendër në Kubë.
  - Eshtë pluhuri si Dash.
  - Eshtë e hollë dhe therëse.
  - Fillojnë muzikën.
  - Një kontinent i ri.
  - Eshtë për medaljen e parë.
  - Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
  - Provinca e boerëve.
  - Eshtë qyteti i njëmbinjë dritareve.
  - Eshtë dukuria.
  - Eshtë hidrokarbur.
  - Griffith aktore.
  - Qe perëndesha e fitores.
  - Mbeten në fund.
  - Tregon çmimin.
  - Këndohet në opera.
  - Para Fe në New Mexico.
  - Eshtë princ arab.
  - Tony që këndon Quando, quando, quando.
  - Bën mëza.
  - Pak tolerante.
  - Modem pa zë.
  - Pak marramendëse.
  - Mbyllin një dyqan.
  - Fillojnë teorikisht.



**Gjeni ndryshimin**

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

						3				
		4				6	8			
5	9		2							7
3			4		5			1	9	
			6	3			4			
	5	7						6		
	4					1	2	9		
1						8	3			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

3	2	7	5	9	4	1	8	6
8	6	4	1	2	7	3	9	5
1	5	9	6	8	3	2	7	4
6	4	1	3	5	8	9	2	7
9	3	5	7	1	2	4	6	8
2	7	8	9	4	6	5	1	3
7	9	2	4	6	5	8	3	1
4	1	3	8	7	9	6	5	2
5	8	6	2	3	1	7	4	9

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Argëtim filozofik*

*Argëtim filozofik*

- Njerëzit janë më normalë se sa mendojnë dhe më të pamoralshëm se sa mendojnë - Sigmond Freud
- Mësoni të lexoni fjalët e dashurisë së heshtur, sepse dashuria e heshtur ka aftësinë të flasë me sytë - William Shakespeare
- Mos prisni që jeta t'ju sjellë përsosmërinë. Uro vetëm, që fati yt të takohet me të vërtetën.
- Vetëm të fortët e gjejnë me vetminë e tyre, të tjerët shikojnë ta mbushin me gjithcka të lirë që gjendet para tyre.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19	S	U	L	M	S	M	M	A	S	A	T				
6	4	1	3		11				3	T	4	R	18	U	1	P	A	R	B	E	E	M	L	I	M	A
13		4		3	2	4	3	2	4	5	3		K	D	E	L	E	G	A	T	E	T		L		
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3		18		M	I	T	O	M	A	N	E	T	D	E			
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3		14	4	K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	T	N		
19			3	2	16	1	4	4	2	3	2		O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	F	T		
	7	4	6	14	5		2			1	11	5		N	I	E	N	O		G	A					
8	11	1		6	11	14		4	2	18	11		P	S	N	N	I	M	A	L	L	I				
3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2		A	M	I	A	N	T	K		O	S	E			
18	8		4	5	7	6	14	6	6	3	5		N	O	T	E	K	I	P	O	R	E				
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	5	3	I	T	N	E	T	I	L	E	N	I	E			
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3	6	K	R	I	M	I	S	I	R	T	A	K	I		

*Thënie të mençura*

- "Mund të përmbledh gjithcka kam mësuar për jetën në një fjalë të vetme: vazhdon"
- "Takojmë shumë njerëz në jetën tonë. Le t'ju japim një mundësi. Çdokush nga ata ka diçka të mrekullueshme për të na ofruar."
- "Të lësh diçka të iki, nuk do të thotë se e harron, por, se e kujton pa frikë"
- "Të gjithë largohen të kalosh kur e di se ku shkon"

